



Vellimir Dellovski

**Ekzekutimi i aktgjykimeve të
Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut –
mekanizmi i Këshillit të Evropës dhe
konteksti institucional kombëtar**

**Ekzekutimi i aktgjykimeve të
Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut –
mekanizmi i Këshillit të Evropës dhe
konteksti institucional kombëtar**

Botues: Misioni i OSBE në Shkup	Publisher: OSCE Mission to Skopje
Autor: Velimir Dellovski	Author: Velimir Delovski
Redaktorë: Darko Pavlovski Artan Murati	Editors: Darko Pavlovski Artan Murati
Përktheu: Blerina Zlatku	Translated by: Blerina Zlatku
Lekturoi: Valon Abdiu	Proofread by: Valon Abdiu
Dizajni grafik: Poliesterdej, Shkup	Graphic design: Polyesterday, Skopje

Ekzekutimi i aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – mekanizmi i Këshillit të Evropës dhe konteksti institucional kombëtar – **978-92-9271-040-8**



Përmbajtja e këtij publikimi nuk përfaqëson medoemos këndvështrimet apo qëndrimet e Misionit të OSBE-së në Shkup.

Materialët në këtë botim janë vetëm për referim. Edhe pse Misioni i OSBE-së në Shkup ka përkushtuar kujdesin më të madh në zhvillimin e tij, i njëjti nuk pranon asnjë përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e informacioneve, udhëzimeve dhe këshillave të ofruara, apo për ndonjë gabim shtypi. Përmbajtja e këtij botimi, pikëpamjet, mendimet, gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare ose qëndrimin e OSBE-së. Për këto arsye, asnjë pretendim nuk mund të bëhet kundër OSBE-së lidhur me pasojat e mundshme nga besueshmëria e informacioneve ose konkluzioneve të përfshira në këtë botim.

Për përdorimin e emrit të vjetër të vendit në këtë botim

Shteti zyrtarisht ndryshoi emrin kushtetues në vitin 2019 në përpuethshmëri me Marrëveshjen e Prespës. Shumica e akteve ligjore të krijuara para ndryshimit të emrit akoma janë në fuqi dhe përmbajnë emrin e mëparshëm të shtetit në titujt e tyre zyrtare. Përdorimi i emrit të mëparshëm të shtetit në këtë dokument bëhet vetëm për shkak të saktësisë ligjore.

Përmbajtja

Parathënie	4
LISTA E AKRONIMEVE TË PËRDORURA	5
HYRJE	6
I. SISTEMI I KËSHILLIT TË EVROPËS PËR EKZEKUTIMIN E AKTGJYKIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT	8
1.1. Detyrimi për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së	8
1.2. Kuadri normativ i Këshillit të Evropës për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së	10
1.3. Reforma e sistemit të mbikëqyrjes së ekzekutimit të aktgjykimeve të GJEDNJ-së	12
1.4. Mekanizmi mbikëqyrës për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së, sistemi i planeve të veprimit dhe raporteve të veprimit	14
1.5. Procedura e mbikëqyrjes së ekzekutimit – sistemi i mbikëqyrjes në “dy korsi”	17
1.6. Aktet e Komitetit të Ministrave	19
1.7. Pjesëmarrja e aplikantëve dhe e subjekteve të tjera në mbikëqyrjen e ekzekutimit	20
II. MASA PËR EKZEKUTIMIN E AKTGJYKIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT	22
II.1. Llojet e masave për ekzekutimin e aktgjykimeve – shënime të përgjithshme dhe kuadri juridik kombëtar	22
II.2. Përzgjedhja e masave për ekzekutimin e aktgjykimeve	25
III. KUADRI DHE PRAKTIKA JURIDIKE DHE INSTITUCIONALE KOMBËTARE E EKZEKUTIMIT TË AKTGJYKIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT	27
III.1. Struktura institucionale për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së në nivel kombëtar	27
III.2. Funksionimi praktik i sistemit të koordinimit të procesit të ekzekutimit të aktgjykimeve të GJEDNJ-së në nivel kombëtar	30
III.3. Pasqyra e gjendjeve lidhur me ekzekutimin e aktgjykimeve kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut	34
III.4. Ndryshimet sistematike në lidhje me ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut	35
PIKËPAMJET PËRFUNDIMTARE	40

Parathënie

Publikimi “Ekzekutimi i aktgjytimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – mekanizmi i Këshillit të Evropës dhe konteksti institucional kombëtar” është pjesa e parë e edicionit që përbëhet nga tri publikime të veçanta, por ngushtë të lidhura midis tyre, hartimi i të cilave u mbështet dhe është nën patronazhin e Misionit të OSBE-së në Shkup, me synimin që të aktualizohet tematika e ekzekutimit të aktgjytimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të begatohen resurset profesionale dhe përmbajtjet në një fushë të caktuar, por edhe me synimin e rritjes së vetëdijes lidhur me rëndësinë e kësaj problematike që ka të bëjë me reformën juridike në Maqedoninë e Veriut.

Në të vërtetë, ky publikim është hyrje në çështjen e ekzekutimit të aktgjytimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me ç’rast prezantohet një pasqyrë e përgjithshme e sistemit të ekzekutimit: sqarohet roli i Komitetit të Ministrave pranë Këshillit të Evropës, në aspektin kuptimor trajtohen dhe kufizohen masat e përgjithshme (të cilat më së shpeshti nënkuptojnë ndryshime ligjore) dhe masat e veçanta (që konkretisht kanë të bëjnë me aplikantët në dobi të të cilëve është miratuar aktgjykimi nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut), ndërsa mes tjerash bëhet edhe një vështrim mbi kontekstin përkatësisht sistemin kombëtar të ekzekutimit të aktgjytimeve të Gjykatës Evropiane në Maqedoninë e Veriut.

Me të drejtë mund të theksohet pritshmëria se ky publikim, si dhe kjo trilogji në përgjithësi, do t’u vijë në ndihmë institucioneve kombëtare të përfshira në ekzekutimin e aktgjytimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të cilat njëherësh, e kanë përgjegjësinë më të madhe për realizimin e të drejtave të njeriut dhe sundimin e të drejtës në shtet. Për më tepër, ky publikim, përkatësisht ky edicion, në të ardhmen duhet të ofrojë stimulim për punë akoma më intensive në këtë materie, duke e pasur parasysh rëndësinë e tij sa i përket avancimit të sundimit të së drejtës, ashtu siç kohë më parë u detektua dhe potencua në të ashtuquajturin Raporti i Pribes nga ana e Bashkimit Evropian.

Hartimi i kësaj trilogjie është pjesë e aktiviteteve programore / të projekteve, të cilat Misioni i OSBE-së në Shkup i ndërmerr me qëllim të përforcimit të kapaciteteve të autoriteteve kombëtare për realizimin dhe shpërndarjen e impenjimeve të OSBE-së në fushën e sundimit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut të cilat janë përfshirë në dimensionin njerëzor të OSBE-së, që paraqet një aspekt thelbësor të mandatit, përkatësisht fushëveprimin të Misionit në Maqedoninë e Veriut.

Për redaktorin
Misioni i OSBE-së në Shkup
Darko Pavlovski, Zyrtar juridik kombëtar
Artan Murati, Zyrtar i sundimit të së drejtës

LISTA E AKRONIMEVE TË PËRDORURA

- KEDNJ** Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut / Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore
- GJEDNJ** Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
- KM** Komiteti i Ministrave
- KNI** Komisioni Ndërinstitucional për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut
- OSBE** Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

HYRJE

Ekzekutimi i aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në tekstin në vijim: “Gjykata”, “GJEDNJ”) është një proces tejet kompleks, i cili përfshin një varg faktorësh të cilët janë përfshirë në vet ekzekutimin ose në monitorimin e ekzekutimit, gjë që e vështirëson zbatimin e masave dhe aktiviteteve të ndryshme të cilat duhet të rezultojnë në një ekzekutim efikas të aktgjykimeve.

Krahas rëndësisë së proceseve të lartpërmendura që kanë të bëjnë me ekzekutimin e aktgjykimeve dhe mbikëqyrjen mbi ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së, megjithatë tek publiku profesionist mungojnë njohuri të thukëta, madje ndonjëherë edhe njohuri themelore të kuadrin juridik vendor dhe institucional që ka të bëjë me ekzekutimin e aktgjykimeve, të miratuara në lëndët maqedonase, me të cilat është konstatuar shkelja e lirive dhe të drejtave të cilat janë të mbrojtura me Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin në vijim: “Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut”, “Konventa”, “KEDNJ”). Njëherësh, një numër i konsiderueshëm i personave nuk i kanë plotësisht të njohur mekanizmat e mbikëqyrjes mbi ekzekutimin e aktgjykimeve të cilat i siguron Këshilli i Evropës, para së gjithash të mishëruara përmes Komitetit të Ministrave (në tekstin në vijim: “Komiteti”, “KM”).

Nga këto shkaqe u imponua nevoja për hartimin e një teksti të këtillë edukativ, i dedikuar për një rreth mjaft të gjerë të përdoruesve, duke i përfshirë: bartësit e pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, në krye të kësaj hierarkie është Gjykata Kushtetuese; gjykatat e apelit dhe të gjitha gjykatat e tjera të rregullta; Gjykata Administrative, Gjykata Kushtetuese, duke e pasur parasysh rolin e saj të rojtarit dhe mbrojtësit të lirive dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë; Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë; organet e administratës të cilat në punën e tyre të përditshme kanë autorizime me të cilat mund t’i ushtrojnë të drejtat e njeriut; avokatët; organizatat joqeveritare nga shoqëria civile dhe ekspertët juridikë të cilët e trajtojnë problematikën që ka të bëjë me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, por edhe me publikun e gjerë laik.

Publikimin që e keni para jush është strukturuar në tri pjesë.

Në pjesën e parë, fillimisht do të prezantohen informacione të caktuara të cilat duhet të mundësojnë këqyrje në kuadrin normativ të Këshillit të Evropës për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së, si dhe në mekanizmin e Komitetit të Ministrave për mbikëqyrje mbi këtë proces.

Në pjesën e dytë, bëhet diferencimi midis masave të veçanta (individuale) dhe masave të përgjithshme (gjenerale) për ekzekutimin e aktgjykimeve, si dhe analizohet shkalla e lirisë (diskrecionit) që u është dhënë autoriteteve kompetente shtetërore në lidhje me përzgjedhjen e masave për ekzekutimin e aktgjykimeve. Nga ana tjetër, është prezantuar vështrimi mbi kuadrin juridik vendor në lidhje me masat e ekzekutimit, në përputhje me Ligjin për ekzekutimin e aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Pjesa e tretë i përkushtohet ekzekutimit të aktgjykimeve të GJEDNJ-së, të miratuara në lëndët kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në këtë kuptim, është prezantuar kuadri juridik dhe strukturat institucionale për ekzekutimin e aktgjykimeve në nivel kombëtar dhe funksionimi i tyre në praktikë. Përveç kësaj, shqyrtohet epilogu dhe arritjet e procesit të ekzekutimit të disa aktgjykimeve më të rëndësishme, që manifestohet përmes ndryshimeve të caktuara dhe të rëndësishme sistematike. Në fund, prezantohet një vështrim i shkurtër mbi gjendjet rrjedhëse dhe tendencat lidhur me ekzekutimin e aktgjykimeve në lëndët maqedonase.

Njohuritë dhe konkluzionet kryesore të këtij publikimi në lidhje me sistemin kombëtar për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së, shkurtimisht janë përmbledhur në kapitullin e fundit të emërtuar si Pikëpamje përfundimtare.

Nga këndvështrimi metodologjik, ky publikim u hartua pas studimeve gjithëpërfshirëse të të gjitha dokumenteve të qasshme në formë elektronike, që kanë të bëjnë me aktet normative vendase me të cilat rregullohet kompetenca dhe procedura e zbatimit të aktgjykimeve të GJEDNJ përmes të cilave monitorohet rrjedha e procesit të ekzekutimit; informacioneve dhe të dhënave për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së, të qasshme në ueb-faqen zyrtare të Byrosë për Përfaqësimin e Shtetit para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, përfshirë këtu edhe raportet vjetore dhe procesverbalet nga mbledhjet e Komisionit Ndërinstitucional për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në tekstin në vijim: “Komisioni Ndërinstitucional”, “KNI”); informacioneve dhe të dhënave për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së, të qasshme në ueb-faqet zyrtare të Komitetit të Ministrave dhe në bazën e të dhënave HUDOC-EXEC, si dhe raportet vjetore dhe dokumentet e tjera relevante të Komitetit të Ministrave; raporteve të Bashkimit Evropian dhe të organizatave të tjera relevante ndërkombëtare.

Në këtë drejtim, duhet t’i shprehim falënderime zonjës Danica Xhonova, Agjente e Qeverisë dhe u.d. Drejtoreshë e Byrosë së Përfaqësimit të Shtetit para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila dha një kontribut të konsiderueshëm në përgatitjen e këtij publikimi.

Në bazë të kësaj që u tha më lartë, mund të besojmë se përmbajtja e këtij publikimi do të kontribuojë në avancimin e njohurive të materies që ka të bëjë me ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së në vendin tonë, ndërsa njohuritë e fituara do të gjejnë aplikim përkatës si në veprimet profesionale individuale, ashtu edhe në praktikën institucionale në nivel kombëtar.

I. SISTEMI I KËSHILLIT TË EVROPËS PËR EKZEKUTIMIN E AKTGJYKIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

I.1. Detyrimi për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut përveç garancive për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, e përmban edhe mekanizmin i cili ka për qëllim të sigurojë një realizim efektiv nga shtetet si palë kontraktuese të kësaj marrëveshje ndërkombëtare. Së këtejmi, një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm ka GJEDNJ-ja e cila në aktgjykimet e saj analizon dhe konstaton nëse shteti e ka shkelur Konventën në ndonjë lëndë konkrete. Me qëllim që aktgjykimet, dhe rrjedhimisht me këtë edhe të drejtat e mbrojtura me Konventën, të mos jenë thjeshtë vetëm një shkronjë e vdekur në letër, vet Konventa në mënyrë eksplicite e parashikon forcën detyruese të aktgjykimeve për shtetet, si dhe kompetencën për ushtrimin e mbikëqyrjes mbi ekzekutimin e tyre. Në këtë kuptim, një rëndësi të veçantë ka neni 46 i Konventës Evropiane.

Neni 46

Forca detyruese dhe ekzekutimi i aktgjykimeve

1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër t'i respektojnë vendimet përfundimtare të Gjykatës në çdo lëndë ku ato janë palë.
2. Aktgjykimi përfundimtar i Gjykatës i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr ekzekutimin e tij.
3. Nëse Komiteti i Ministrave është i mendimit se mbikëqyrja e ekzekutimit të aktgjykimet përfundimtar pengohet nga një problem i interpretimit të aktgjykimet, ai mund t'ia referojë çështjen Gjykatës për t'u shprehur me vendim për çështjen e interpretimit. Një vendim i tillë kërkon një shumicë prej dy të tretave të përfaqësuesve që kanë të drejtë të marrin pjesë në Komitet.
4. Nëse Komiteti i Ministrave është i mendimit se një Palë e Lartë Kontraktuese refuzon të respektojë një aktgjykim përfundimtar të Gjykatës në një çështje ku ajo është palë, pasi t'i ketë dërguar një njoftim formal asaj Palë dhe me vendim që merret me një shumicë prej dy të tretave të përfaqësuesve që marrin pjesë në Komitet, ai mund t'ia referojë Gjykatës çështjen nëse Pala e ka përmbushur detyrimin e saj në bazë të paragrafit 1.
5. Nëse Gjykata gjen një shkelje të paragrafit 1, ajo ia referon çështjen Komitetit të Ministrave për shqyrtimin e masave që duhen marrë. Nëse Gjykata nuk gjen asnjë shkelje të paragrafit 1, ajo ia referon çështjen Komitetit të Ministrave, i cili e mbyll shqyrtimin e çështjes.

Nga teksti i nenit 46 paragrafi 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, shihet se aktgjykimet e GJEDNJ-së kanë forcë detyruese, që nënkupton se shtetet duhet të ndërmarrin detyrime që t'i respektojnë aktgjykimet përfundimtare dhe ato të formës së prerë të Gjykatës në çdo lëndë në të cilën ato janë palë. Neni 46 zbatohet për çdo aktgjykim në të cilin Gjykata ka konstatuar shkelje të Konventës, e që ia imponon shtetit përgjegjës detyrimin juridik t'i vë fund shkeljes dhe të sigurojë dëmshpërblim për pasojat e tij.¹

¹ Papamichalopoulos and Others v. Greece (Article 50), 31 October 1995, § 34, Series A no. 330-B

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, në parim, kanë **tre detyrime** pas miratimit të aktgjykimet të pavolitshëm (negativ) me të cilin konstatohet shkelja e Konventës: (1) ta paguajnë kompensimin nëse i njëjti u është përcaktuar; (2) nëse një gjë e këtillë është e domosdoshme, të ndërmarrin masa të mëtutjeshme individuale në dobi të aplikantit, përkatësisht t'i vënë fund shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe t'i rikuperojnë pasojat në mënyrë që aplikantin do ta vë, në një masë aq sa është e mundur, në gjendjen e mëparshme, përkatësisht në situatë e cila ka ekzistuar para shkeljes (*restitutio in integrum*);² dhe (3) të ndërmarrin masa të karakterit të përgjithshëm me qëllim që të sigurojnë mospërsëritje të shkeljeve të ngjashme në të ardhmen.³

Shteti i paditur, i cili është përgjegjës për shkeljen e kryer mbi liritë dhe të drejtat të cilat i mbron Konventa, ka shkallë të lartë të fleksibilitetit në përzgjedhjen e mjeteve me të cilat ai do ta përmbushë detyrimin e vet juridik nga neni 46 të Konventës. Kjo rezulton nga **parimi i subsidiaritetit**, në të cilin bazohet sistemi i përgjithshëm i Konventës, përfshirë këtu edhe ekzekutimin e aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane. Ky parim, i cili fillimisht u zhvillua si doktrinë në praktikën e Gjykatës Evropiane, ndërsa kohë më parë në mënyrë eksplicite u sanksionua në Preambulën e Konventës përmes Protokollit nr. 15⁴, i cili hyri në fuqi më 1 gusht të vitit 2021, e potencon **përgjegjësinë primare të autoriteteve vendase t'i respektojnë dhe garantojnë liritë dhe të drejtat e garantuara me Konventën**, t'i përcaktojnë masat më përkatëse për këtë qëllim, si dhe të sigurojnë përputhshmëri me aktgjykimet përfundimtare të miratuara nga Gjykata përmes bashkëpunimit dhe koordinimit të të gjitha degëve dhe organeve të pushtetit.

Megjithatë, përzgjedhja e mjeteve dhe mënyra e zbatimit të tyre praktik nuk është e pakufizuar dhe është objekt shqyrtimi nga Komiteti i Ministrave pranë Këshillit të Evropës. Makineria e mbikëqyrjes së ekzekutimit të aktgjykimeve nga ana e shteteve, paraqet një karakteristikë unike të sistemit të Konventës, dhe e njëjta e ka bazën e vet juridike në nenin 46 paragrafin 2 të Konventës, i cili i jep kompetencë Komitetit të Ministrave që të ushtrorë mbikëqyrje. Kjo mbikëqyrje ushtrohet në përputhje me **Rregullat e Komitetit të Ministrave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të aktgjykimeve dhe mbikëqyrjen e kushteve për ujdmi miqësore** (në tekstin në vijim: "Rregulla të KM-së për mbikëqyrjen e ekzekutimit").⁵

Marrë në përgjithësi, për çdo lëndë (ose grup të lëndëve të ngjashme) KM-ja i shqyrtton masat për tejkalimin e shkeljes së Konventës të cilat i ka propozuar shteti gjatë takimeve të veçanta tematike për të drejtat e njeriut të Komitetit (të ashtuquajtura **Takime DH**), të cilat mbahen katër herë brenda vitit (në muajin mars, qershor, shtator dhe dhjetor). Së këtejmi, Komiteti

² *Akdivar and Others v. Turkey* (Article 50), 1 April 1998, §47, Reports of Judgments and Decisions 1998-II

³ *Broniowski v. Poland* [GC], no. 31443/96, § 193, ECHR 2004-V

⁴ Protokoll nr. 15 për ndryshimin e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (CETS nr. 213), Strasburg, 24 qershor 2013

⁵ Rules of the Committee of Ministers for the supervision of the execution of judgments and of the terms of friendly settlements (Adopted by the Committee of Ministers on 10 May 2006 at the 964th meeting of the Ministers' Deputies and amended on 18 January 2017 at the 1275th meeting of the Ministers' Deputies), https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016806dd2a5

miraton rezolutë përfundimtare për mbylljen e lëndës kur do të konstatojë se është vepruar në përputhje me aktgjykimin, përkatësisht se i njëjti është ekzekutuar.

Edhe pse sipas rregullit, GJEDNJ-ja nuk përfshihet në mbikëqyrjen e ekzekutimit, Konventa parashikon mundësi për përfshirjen e saj në këtë proces edhe atë në dy situata:

- nëse Komiteti i Ministrave është i mendimit se mbikëqyrja e ekzekutimit është penguar nga ndonjë problem që ka të bëjë me interpretimin e aktgjykimit, atëherë ai ka mundësi me vendim të miratuar me shumicën e votave të anëtarëve të Komitetit këtë çështje t'ia referojë Gjykatës e cila do të vendos për çështjen e interpretimit (neni 46 paragrafi 3) dhe
- nëse Komiteti i Ministrave është i mendimit se shteti refuzon ta respektojë aktgjykimin përfundimtar në lëndën në të cilën ai është palë, ai mundet, pasi që do ta njoftojë formalisht shtetin edhe me vendimin e miratuar me dy të tretën e shumicës së votave të anëtarëve të Komitetit, çështjet t'ia referojë Gjykatës nëse shteti në fjalë i ka plotësuar detyrimet e veta nga paragrafi 1 (neni 46 paragrafi 4). Rrjedhimisht me këtë, nëse Gjykata gjen shkelje, atëherë ajo lëndën duhet t'ia kthejë mbrapsht KM-së që t'i shqyrtojë masat të cilat duhet të ndërmerren (neni 46 paragrafi 5).⁶

I.2. **Kuadri normativ i Këshillit të Evropës për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së**

Kuadrin normativ për ekzekutimin e aktgjykimeve të Strasburgut e përbëjnë standarde të cilat janë inkorporuar në një varg instrumentesh të ashtuquajtura si “ligj i butë” (*soft law*) të Këshillit të Evropës. Në mesin e tyre, rëndësi vendimtare ka **Rekomandimi CM/Rec(2008)2 i Komitetit të Ministrave drejtuar shteteve anëtare për kapacitetin efikas vendor në lidhje me ekzekutimin e shpejtë të aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.**⁷

Në të theksohet nevoja e fuqizimit të kapaciteteve vendore për ekzekutimin e aktvendimeve të Gjykatës⁸ dhe nënvizohet “Rëndësia e informimit të hershëm dhe koordinimi efektiv i të

gjithë faktorëve të shtetit të përfshirë në procesin e ekzekutimit”.⁹

Duke i pasur parasysh praktikën e ndryshme kombëtare, Rekomandimi CM/Rec(2008)2 nuk shkon deri aty që ta përcaktojë Agjentin e Qeverisë / shtetin si koordinatör i procesit të ekzekutimit të aktgjykimeve, edhe pse ai thekson më të madh e vë mbi rolin e Agjentit si organ koordinues qendror në mbikëqyrjen e ekzekutimit të aktgjykimeve të Gjykatës, veçanërisht duke e pasur parasysh faktin se detyrimet e zakonshme të tij janë shumë të ngjashme me ato që janë përcaktuar me rekomandimin.

Më konkretisht, në përputhje me këtë Rekomandim nga shtetet pritet:

- të caktojnë **individin ose autoritetin / organin si koordinatör të ekzekutimit** të aktgjykimeve në nivel kombëtar, me kontakte referente tek autoritetet relevante kombëtare të përfshira në procesin e ekzekutimit, që do t'i kishte autorizimet e nevojshme dhe autoritetin të sigurojë informacione relevante dhe të ndërlidhet me personat ose organet përgjegjëse në nivel kombëtar për vendosjen e masave të nevojshme që të ekzekutohet aktgjykimi dhe nëse është e nevojshme, të ndërmarrë ose iniciojë masa relevante që të përshpejtohet procesi (paragrafi 1). Koordinatorin duhet ta ketë rolin kyç në identifikimin e masave për ekzekutim (paragrafi 4) dhe gjatë hartimit të planeve të veprimit (paragrafi 6);
- ta lehtësojë dhe ndihmojë miratimin e masave të dobishme në mënyrë që të zhvillohen sinergji efikase midis faktorëve relevantë në procesin e ekzekutimit në nivel kombëtar dhe të identifikohen kompetencat e tyre përkatëse (paragrafi 5);
- të ndërmerr hapa të nevojshëm në mënyrë që të sigurohet se të gjitha aktgjykimet janë ekzekutuar, dhe se të gjitha aktgjykimet, vendimet relevante dhe rezolutat e Komitetit të Ministrave, janë shpërndarë në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë deri te faktorët relevantë në procesin e ekzekutimit, ndërsa kur një gjë e këtillë është e domosdoshme, të përkthyer, kështu që ata të njoftohen në mënyrë adekuate me praktikën gjyqësore të Gjykatës, si dhe me rekomandimet dhe praktikën e Komitetit të Ministrave (paragrafi 3 dhe 7).

Në mënyrë plotësuese,

- shtetet anëtare duhet ta sigurojnë ekzistimin e mekanizmave përkatës për dialog efektiv dhe për transmissiönin e informacioneve relevante midis koordinatorëve dhe Komitetit të Ministrave (paragrafi 2);
- parlamentet të informohen me situatën e ekzekutimit të aktgjykimeve dhe me masat që janë ndërmarrë në këtë drejtim (paragrafi 9) dhe

⁶ Mundësia e këtillë për ngritjen e procedurës për shkeljen e nenit 46, u inkorporua në KEDNJ në vitin 2010, dhe ajo është zbatuar për herë të parë, në vitin 2017, kundër Azerbajxhanit, për shkak të refuzimit të vazhdueshëm të autoriteteve kompetente ta sigurojnë lëshimin e pakushtëzuar në liri të aplikantit (aktivist politik) në mënyrë që të ekzekutohet aktgjykimi në lëndën *Ilgar Mammadov v. Azerbaijan*, no. 15172/13, 22 maj 2014. Dhoma e madhe në vitin 2019, konstatoi se Azerbajxhani nuk e përmbushi detyrimin e vet që ta respektojë aktgjykimin e Gjykatës nga viti 2014, me ç'rast është shkelur neni 46 paragrafi 1 i KEDNJ. Për më shumë detaje shih *Ilgar Mammadov v. Azerbaijan* [GC], no. 15172/13, 29 May 2019.

⁷ Recommendation CM/Rec(2008)2 of the Committee of Ministers to Member States on efficient domestic capacity for rapid execution of judgments of the European Court of Human Rights, Adopted by the Committee of Ministers on 6 February 2008 at its 1017th Session.

⁸ Shih paragrafin g.

⁹ Shih paragrafin h. Në paragrafin i. Ky Rekomandim ka të bëjë edhe me Rekomandimin e Asamblesë Parlamentare 1764 (2002) “Implementimi i aktgjykimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut” (Parliamentary Assembly Recommendation 1764 (2006) “Implementation of the judgments of the European Court of Human Rights” adopted on 2 October 2006 (24th Sitting)). Aty “rekomandohet Komiteti i Ministrave t'i stimulojë shtetet anëtare t'i përmirësojnë, apo aty ku një gjë e këtillë është më se e nevojshme, të vendosin mekanizma dhe procedura vendore, si në nivel të qeverive, ashtu edhe në nivel të parlamenteve që të sigurojnë ekzekutim në kohë të duhur dhe efektiv të aktgjykimeve të Gjykatës, përmes veprimit të koordinuar të të gjithë faktorëve të interesuar kombëtarë dhe me mbështetjen e nevojshme në nivelin më të lartë politik”.

☛ të ndërmerren të gjitha veprimet e domosdoshme për rikuperimin e shkeljes në nivel të lartë, nëse nevojitet edhe në nivel politik, kur një gjë të këtillë e kërkon një problem i vazhdueshëm dhe i rëndësishëm në procesin e ekzekutimit (paragrafi 10).

Përveç Rekomandimit CM/Rec(2008)2, Komiteti i Ministrave ka miratuar edhe disa rekomandime të tjera, qëllimi i të cilave është përmirësimi i implementimit kombëtar të Konventës, të cilat, mes tjerash, kanë të bëjnë edhe me ekzekutimin e aktgjyqimeve të GJEDNJ-së.¹⁰

1.3. Reforma e sistemit të mbikëqyrjes së ekzekutimit të aktgjyqimeve të GJEDNJ-së

Disa standarde të caktuara sa i përket ekzekutimit të aktgjyqimeve të Gjykatës janë rezultat edhe i reformës së rëndësishme të sistemit të Konventës, e cila u iniciua në Konferencën e mbajtur në Interlaken në vitin 2010. Edhe pse fillon në kontekstin e rritjes së vazhdueshme të vëllimit të punës gjyqësore në Gjykatë, kjo reformë, njëkohësisht, fokusohet edhe në mbikëqyrjen e KM-së mbi ekzekutimin e aktgjyqimeve të Gjykatës.

Duke filluar nga viti 2010, në kuadër të procesit të reformave nga Interlaken janë miratuar katër deklarata në konferencat e nivelit të lartë të mbajtura në Izmir (2011)¹¹, Brajton (2012)¹²,

¹⁰ Këtu bëjnë pjesë: Rekomandimi për rishikimin ose rihapjen e procedurës gjyqësore për raste të caktuara në nivel kombëtar sipas aktgjykimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut [Recommendation No. R (2000) 2 of the Committee of Ministers to Member States on the re-examination or reopening of certain cases at domestic level following judgments of the European Court of Human Rights, Adopted by the Committee of Ministers on 19 January 2000 at its 694th Session]; Rekomandimi për publikimin dhe shpërndarjen në shtetet anëtare të tekstit të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; [Recommendation CM/Rec(2002)13 of the Committee of Ministers to Member States on the publication and dissemination in the Member States of the text of the European Convention of Human Rights, Adopted by the Committee of Ministers on 18 December 2002 at its 822nd Session]; Rekomandimi për verifikimin e harmonizimit të draft-ligjeve, ligjeve ekzistuese dhe praktikës administrative me standardet e specifikuar në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut; [Recommendation CM/Rec(2004)5 of the Committee of Ministers to Member States on the verification of the compatibility of draft laws, existing laws and administrative practice with standards laid down in the European Convention on Human Rights, Adopted by the Committee of Ministers on 12 May 2004 at its 114th Session]; Rekomandimi për përmirësimin e mjeteve juridike vendore [Recommendation CM/Rec(2004)6 of the Committee of Ministers to Member States on the improvement of domestic remedies, Adopted by the Committee of Ministers on 24 February 2010 at its 1077th Session]; Rekomandimi për mjete juridike efektive për zvarritjen e procedurave [Recommendation CM/Rec(2010)3 of the Committee of Ministers to Member States on effective remedies for excessive length of proceedings, Adopted by the Committee of Ministers on 24 February 2010 at the 1077th meeting of the Ministers' Deputies]; Rekomandimi për sistemin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në arsimin universitar dhe trajnimin profesional [Recommendation CM/Rec(2019)5 of the Committee of Ministers to Member States on the system of the European Convention on Human Rights in university education and professional training, replacing Recommendation Rec(2004)4 of the Committee of Ministers to Member States on the European Convention on Human Rights in university education and professional training, Adopted by the Committee of Ministers on 16 October 2019 at the 1357th meeting of the Ministers' Deputies].

¹¹ Shih: Izmir Declaration of 26/27 April 2011 of the High Level Conference on the Future of the European Court of Human Rights

¹² Shih: Brighton Declaration of 19/20 April 2012 of the High Level Conference on the Future of the European Court of Human Rights

Bruksel (2015)¹³ dhe Kopenhagë (2018)¹⁴, në të cilat shqyrtohen masat e propozuara që të garantohet efektiviteti afatgjatë i sistemit të Konventës dhe ardhmëria e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në të gjitha këto dokumente theksi vendoset mbi parimin e subsidiaritetit, si dhe mbi përgjegjësinë e ndarë tek autoritetet vendore dhe tek Këshilli i Evropës në lidhje me implementimin kombëtar të Konventës.

Për shembull, **Deklarata e Brajtonit**, i inkurajon shtetet “të zhvillojnë kapacitete dhe mekanizma vendorë në mënyrë që të sigurojnë ekzekutim të shpejtë të aktgjyqimeve të Gjykatës”, së këtejmi “do të zhvillojnë dhe do të shpërndajnë resurse të mjaftueshme në nivel kombëtar në drejtim të ekzekutimit të plotë dhe efektiv të të gjitha aktgjyqimeve, ndërsa agjentëve qeveritarë ose personave të tjerë zyrtarë përgjegjës për koordinimin e ekzekutimit të aktgjyqimeve do t’u ofrojnë mjete adekuate dhe autoritet.”¹⁵

Deklarata e Brukselit, e identifikon rolin e gjyqësorit dhe përfshirjen e parlamenteve në ekzekutimin,¹⁶ “përmes dërgesës deri te ata, të raporteve vjetore ose tematike ose përmes organizimit të debateve me pushtetin ekzekutiv për implementimin e aktgjyqimeve të caktuara”,¹⁷ përfshirë këtu edhe prezencën e “përfaqësuesve të institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut dhe të shoqërisë civile.”¹⁸ Për më tepër, Deklarata rekomandon “ngritjen e pikave të kontaktit” për çështjet e të drejtave të njeriut në kuadër të organeve relevante ekzekutive, gjyqësore dhe ligjvënëse, si dhe krijimin e rrjeteve midis tyre përmes takimeve, shkëmbimit të informacioneve...”¹⁹

Pikëpamjet e përcaktuara në Deklaratën e Brukselit dhe rekomandimet që i përfshin kjo deklaratë në masë të madhe janë riafirmuar edhe në tekstin e **Deklaratës së Kopenhagës** (paragrafi 22).

Kësaj reforme të madhe të sistemit të ekzekutimit dhe fuqizimit të strukturave kombëtare për koordinimin dhe zbatimin e ekzekutimit, fillimisht e artikuluar përmes konferencave dhe deklaratave në nivel të lartë ndërqeveritar, konform kësaj, është më se e nevojshme t’i bashkëngjitet roli gjithnjë e më i madh i parlamenteve në mbikëqyrjen e ekzekutimit të aktgjyqimeve të GJEDNJ-së. Në këtë kuptim, kemi aktivitet të konsiderueshëm të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, e cila në mënyrë të veçantë e thekson nevojën e

¹³ Shih: Brussels Declaration of 27 March 2015 of the High-level Conference on the “Implementation of the European Convention on Human Rights, our shared responsibility”

¹⁴ Shih: Copenhagen Declaration of 12/13 April 2018 of the High-Level Conference on “Continued Reform of the European Court of Human Rights Convention System – Better balance, improved Protection”

¹⁵ Shih: Brussels Declaration, i cituar më lartë, Action Plan, Point B., paragrafi 2. c.

¹⁶ Action Plan, pjesa B., paragrafi 1. c.

¹⁷ Action Plan, pjesa B., paragrafi 1. h.

¹⁸ Action Plan, pjesa B., paragrafi 2. j.

¹⁹ Action Plan, pjesa B., paragrafi 2. i.

përfshirjes më të madhe dhe më aktive të parlamenteve në procesin e ekzekutimit.²⁰

Së këtejmi, zhvillimi i mekanizmave dhe strukturave të veçanta parlamentare të cilat do ta monitorojnë dhe mbështesin këtë proces, në mënyrë të veçantë theksohet në **Rekomandimin 1764 (2006), Rezolutën 2178 (2017) dhe Rezolutën 1823 (2011)**. Në këtë kontekst, kërkohet edhe organizimi i debateve të veçanta parlamentare që u përkushtohen implementimit të aktgjytimeve të GJEDNJ, me prezencën e përfaqësuesve qeveritarë, të cilët do të raportojnë për progresin e arritur të ekzekutimit, por do të prezantoheshin edhe raportet vjetore në këtë temë dhe do të harmonizoheshin përpjekjet e të gjitha grupeve politike që të sigurohet se aktgjykimet e Gjykatës implementohen.²¹

Në të vërtetë, në këtë drejtim, **Rezoluta, 1823 (2011)** në mesin e shumë funksioneve që duhet t'i kryejnë deputetët në këtë fushë, i përcakton si vijon: sigurimi i procedurave përkatëse parlamentare për verifikimin sistematik të kompatibilitetit të draft-legjislacionit me standardet e Konventës; mbikëqyrja e hapave të ndërmarrja nga ana e organeve kompetente për ekzekutimin e aktgjytimeve negative për shtetin (në kuptimin e asaj se me të njëjtat është konstatuar shkelja e KEDNJ-së), duke e përfshirë edhe kontrollin (mbikëqyrjen) e masave faktikisht të ndërmarrja; si dhe vendosja dhe/ose fuqizimi i strukturave për orientim dhe mbikëqyrje të rreptë mbi detyrimet e tyre ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të njeriut.²²

1.4. Mekanizmi mbikëqyrës për ekzekutimin e aktgjytimeve të GJEDNJ-së, sistemi i planeve të veprimit dhe raporteve të veprimit

Rëndësi jashtëzakonisht të madhe për mënyrën e veprimit gjatë zbatimit të mbikëqyrjes mbi ekzekutimin kanë **Rregullat** e lartpërmendura të **Komitetit të Ministrave për mbikëqyrjen e ekzekutimit**.²³

Me këto Rregulla, shtetet e kanë për detyrë të paraqesin plane të veprimit dhe/ose raporte të veprimit për ekzekutimin e aktgjytimeve të Gjykatës në kuadër të afateve të përcaktuara,

²⁰ PACE [Resolution 1516 \(2006\)](#) on the implementation of judgments of the European Court of Human Rights; [Resolution 1726 \(2010\)](#) on the effective implementation of the European Convention on Human Rights: the Interlaken process; PACE Resolution 1787(2011) "The implementation of judgments of the European Court of Human Rights", adopted on 26 January 2011 (6th Sitting); PACE Resolution 2055 (2015) "The effectiveness of the European Convention on Human Rights: the Brighton Declaration and beyond"; PACE Resolution 2178 (2017) "The implementation of judgments of the European Court of Human Rights", adopted on 29 June 2017 (26th Sitting), paragrafi 1 dhe 2. Po ashtu, shih Rezolutat 2075 (2015), 1787 (2011) dhe 1516 (2006) dhe Rekomandimet 2079 (2015) dhe 1955 (2011), që kanë të bëjnë me implementimin e aktgjytimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

²¹ PACE Resolution 2178 (2017), e cituar më lart, paragrafi 10

²² PACE Resolution 1823 (2011), "National parliaments: guarantors of human rights in Europe", adopted on 23 June 2011 (25th Sitting), paragrafi 6.

²³ Për këqyrjen e plotë të këtyre Rregullave shih përkthimin e tyre në gjuhën maqedonase, i qasshëm në ueb-faqen e Byrosë së Përfaqësimit, këtu: <http://bireoscp.gov.mk/wp-content/uploads/2020/10/%D0%9F%D1%80%D0%B0%D0%B2%D0%B8%D0%BB%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%9A%D0%BE%D0%BC%D0%B8%D1%82%D0%B5%D1%82-%D0%BD%D0%B0-%D0%9C%D0%B8%D0%BD%D0%B8%D1%81%D1%82%D1%80%D0%B8.pdf>

por më së voni në afat prej gjashtë muajsh nga data kur aktgjykimi është bërë i formës së prerë.²⁴ Në këtë mënyrë, përfshihet një dinamikë e caktuar kohore gjatë raportimit dhe monitorimit të progresit eventual të ekzekutimit.

Në të vërtetë, planet e veprimit dhe raportet e veprimit u inkorporuan në vitin 2004, ndërsa u bënë pjesë përbërëse e procesit të mbikëqyrjes në vitin 2009, si mekanizma kryesorë përmes të cilëve duhet të fuqizohet dialogu midis Komitetit të Ministrave dhe shteteve, por edhe me faktorët e tjerë relevantë, përfshirë këtu edhe parlamentet.²⁵ Paraqitja e tyre u bë e detyrueshme me reformën e metodave të punës të KM-së pas konferencës së mbajtur në Interlaken më 1 janar të vitit 2011.²⁶

Gjatë paraqitjes së planeve të veprimit është bërë praktikë e zakonshme fillimisht deri te Komiteti i Ministrave, të paraqitet **plani iniciues i veprimit**, i cili i përmban vetëm ato masa që mund të parashikohen në stadin fillestar të ekzekutimit. Pastaj, varësisht nga zhvillimi i ngjarjeve në nivel kombëtar, ekziston mundësia në intervale të caktuara kohore të paraqiten **plan veprime të rishikuara**, në të cilat theksohet progresi në lidhje me zbatimin e aktiviteteve të paralajmëruara në planin iniciues ose prezantohen hapa krejtësisht të rinj, përkatësisht masa plotësuese, ndërmarrja e të cilave është treguar si e nevojshme në ndonjë fazë të mëvonshme të procesit të ekzekutimit të aktgjykimin konkret, të cilat madje nuk janë parashikuar në planin iniciues të veprimit. Në këtë mënyrë, bëhet azhurnimi adekuat i planit iniciues të veprimit dhe njoftimi në kohë të duhur i Komitetit në lidhje me rrjedhën e re të aktiviteteve që kanë të bëjnë me procesin e ekzekutimit.

Përveç planeve të veprimit në të cilët specifikohen masat të cilat shteti i paditur synon t'i ndërmarrë në mënyrë që ta ekzekutojë aktgjykimin e Gjykatës, bashkë me kornizën indikative kohore brenda afateve në të cilat planifikohet ndërmarrja e të njëjtave, ekzistojnë edhe raportet e veprimit, të cilët i specifikojnë masat të cilat tanimë janë ndërmarrë për ekzekutimin e aktgjykimin dhe i sqarojnë motivet për shkak të të cilave shteti konsideron se nuk janë të nevojshme masa të tjera plotësuese.²⁷

²⁴ 2019 Annual Report of the Committee of Ministers on the supervision of the execution of judgments and decisions of the European Court of Human Rights, i qasshëm në: <https://rm.coe.int/annual-report-2019/16809ec315>, fq. 11

²⁵ Brussels Declaration of 27 March 2015 of the High-level Conference on the "Implementation of the European Convention on Human Rights, our shared responsibility", Action Plan, pjesa B., paragrafi 2 a.

²⁶ Decision of the Committee of Ministers of 2 December 2010 (1100 DH meeting) <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=090000168059acda>. Po ashtu, shih Information document CM/Inf/DH(2010)37, 6 September 2010 – Supervision of the execution of judgments and decisions of the European Court of Human Rights: Implementation of the Interlaken Action Plan – Modalities for a twin-track supervision system and Information document CM/Inf/DH(2010)45 final, 7 December 2010 – Supervision of the execution of judgments and decisions of the European Court of Human Rights: Implementation of the Interlaken Action Plan – Outstanding issues concerning the practical modalities of implementation of the new twin-track supervision system, i qasshëm në: <https://www.coe.int/en/web/execution/rules-and-working-methods>.

²⁷ Udhëzime të dobishme praktike për hartimin e planeve të veprimit dhe raporteve të veprimit janë dhënë në *Udhëzuesin për të shkruar plane të veprimit dhe raporte të veprimit për ekzekutimin e aktgjytimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut [Guide for the drafting of action plans and reports for the execution of judgments of the European Court of Human Rights]*, i qasshëm në: <https://rm.coe.int/guide-drafting-action-plans-reports-en/1680592206>

Raportet e veprimit, në parim, korrespondojnë me planin e veprimit paraprakisht të paraqitur ose me planet e veprimit, disa prej të cilëve janë të azhurnuar, përkatësisht rishikuar, meqë nga të njëjtit reflektohen aktivitetet tanimë të realizuara të cilat ishin theksuar në planin e veprimit paraprakisht të hartuar dhe të paraqitur ose në planet e veprimit paraprakisht të paraqitur. Pas pranimit të planit fillestar të veprimit, të paraqitur nga shteti, Departamenti i Ekzekutimit të Aktgjykimeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme në kuadër të Këshillit të Evropës (i cili vepron si mbështetje profesionale, përkatësisht si Sekretariat i Komitetit të Ministrave) bën vlerësime preliminare të masave të parashikuara për implementimin edhe të dinamikës së propozuar për zbatimin e tyre. Në këtë fazë, Departamenti i Ekzekutimit të Aktgjykimeve mund të kërkojë nga shteti informacione, raportime dhe sqarime plotësuese ose diçka tjetër, me qëllim të harmonizimit të tekstit të planit të veprimit të propozuar.

Me inkorporimin e sistemit të planeve të veprimit dhe raporteve të veprimit, në të vërtetë u mundësua mbikëqyrja e vazhdueshme e zhvillimit të ri të ngjarjeve sa i përket ekzekutimit në lidhje me çdo lëndë konkrete e cila monitorohet nga KM-ja, veçanërisht duke e pasur parasysh se në këtë mënyrë u krijuan kanale për komunikime dhe konsulta më të thjeshta dhe më efikase midis KM-së dhe Departamentit për Ekzekutimin e Aktgjykimeve, nga njëra anë, dhe midis vet shteteve, nga ana tjetër.

Për më tepër, duhet të theksohet se funksioni mbikëqyrës i Komitetit të Ministrave e përfshin edhe monitorimin e pagesës së dëmshpërblimit të drejtë për të cilin kushtet e ekzekutimit më së shpeshti janë pjesë përbërëse të vet aktgjykimit të GJEDNJ-së me të cilin një gjë e këtillë është përcaktuar (afati i pagesës, valuta, kamata e vonesës, etj). Në kompetencë të tij është edhe ekzekutimi i vendimeve për zgjidhjen me ujdi të lëndëve të miratuara nga ana GJEDNJ-së në bazë të **ujdive miqësore** të arritura midis shtetit dhe aplikantit, përkatësisht aplikantëve, konform nenit 39 paragrafi 4 të KEDNJ-së.²⁸

Nga ana tjetër, KM-ja nuk e monitoron ekzekutimin e vendimeve të miratuara në bazë të **deklaratave të njëanshme**, të cilat janë deklarime të njëanshme me të cilat shtetet në mënyrë eksplicite e pranojnë shkeljen e KEDNJ-së dhe e pranojnë ekzekutimin e detyrimeve të caktuara (më së shpeshti për pagesën e shumës monetare si kompensim i drejtë). Megjithatë, duhet të merret parasysh mundësia që aplikanti të kërkojë lënda e tij të kthehet në listën e lëndëve dhe të ketë vendim meritator nga GJEDNJ-ja, nëse shteti nuk i realizon detyrimet e ndërmarra nga ana e tij në deklaratën e njëanshme të deklamuar, të verifikuar me vendim të

²⁸ Neni 39 i KEDNJ-së e parashikon mundësinë për zgjidhjen e kontestit me ujdi përmes arritjes së ujdise miqësore midis palëve në cilindo qoftë stad të procedurës, me atë që kjo dispozitë është ndryshuar në mënyrë plotësuese me Rregullin 62 të Rregullores së Gjykatës. Ujditë miqësore arrihen në procedurën e cila duhet të implementohet përmes negociatave rreptësisht të konfidenciale midis palëve. Ato në përgjithësi e detyrojnë shtetin t'i paguaj aplikantit një shumë të caktuar monetare, pa u pranuar zyrtarisht shkeljen e pretenduar të Konventës. Në parim, Gjykata e stimulon përdorimin e ujdive miqësore meqë ato mundësojnë veprim më të shpejtë ndaj lëndëve, veçanërisht në ato lëndë për të cilat ekziston praktikë tanimë e vendosur gjyqësore, kështu që Gjykata me automatizëm iu propozon palëve një shumë të caktuar të mjeteve e cila korrespondon me seriozitetin e shkeljes së pretenduar dhe përputhet me shumën të cilat Gjykata ua cakton çështjeve të ngjashme, me qëllim që ta lehtësojë dhe përshpejtojë ujdinë miqësore.

Gjykatës, me të cilin u aprovua deklarata e njëanshme.²⁹

1.5. Procedura e mbikëqyrjes së ekzekutimit – sistemi i mbikëqyrjes në “dy korsitë”

Në përputhje me Rregullin 4 të Rregullores së KM-së për mbikëqyrjen e ekzekutimit, është parashikuar politikë e shqyrtimit të lëndëve e që nënkupton që do t'i jepet përparësi mbikëqyrjes mbi ekzekutimin e aktgjykimeve në të cilat Gjykata ka konstatuar ekzistim të problemit sistematik në përputhje me **Rezolutën Res(2004)3 të Komitetit të Ministrave që ka të bëjë me aktgjykimet të cilat zbulojnë problem thelbësor sistematik**.³⁰ Njëherësh, në mënyrë të qartë vihet në dukje se prioriteti i këtillë nuk do të jetë në llogari të çështjeve tjera të rëndësishme, veçanërisht të çështjeve në të cilat shkelja e konstatuar ka shkaktuar pasoja serioze për palën e dëmtuar.

Mbikëqyrja e ekzekutimit të aktgjykimeve të cilën e implementon Komiteti i Ministrave, përveç pagesës së dëmshpërblimit të caktuar fillestar nga ana e Gjykatës, i përfshin edhe masat e ndërmarra të veçanta (individuale), të cilat duhet të sigurojnë mbylljen e shkeljes dhe kthimin e aplikantit si palë e dëmtuar, aq sa është e mundur, në gjendjen e njëjtë në të cilën ka qenë para shkeljes së Konventës, si dhe masat e miratuara të përgjithshme (gjenerale), të cilat duhet t'i parandalojnë shkeljet e ngjashme të reja si ato të cilat tanimë janë konstatuar ose t'u vënë fund shkeljeve të vazhdueshme (Rregulli 6 paragrafi 2).

Zakonisht, mbikëqyrja e ekzekutimit zbatohet për një lëndë të caktuar konkrete ose për një grup lëndësh, të cilat janë kategorizuar sipas llojit të shkeljes, përkatësisht sipas llojit të masave që duhet të ndërmerren në drejtim të ekzekutimit të tyre. Në këtë kuptim, nëse kundër shtetit të njëjtë janë miratuar dy ose më shumë aktgjykime me të cilat konstatohet shkelje e njëjtë e KEDNJ-së, me qëllim që të sigurohet unifikimi i veprimeve të ndërmarra, veçanërisht në kontekst të masave të përgjithshme, në nivelin në të cilin ato janë njëlloj relevante për të gjitha lëndët e prekura, ato do të përfshihen dhe shqyrtohen në kuadër të grupit të njëjtë të lëndëve.

²⁹ Zakonisht, pas mospërfitimit të tentativës që të arrihet ujdi miqësore meqë aplikanti i ka refuzuar kushtet e propozimit për ujdi miqësore, shteti i paditur paraqet deklaratë të njëanshme (deklaratë unilaterale) me të cilën do të kërkojë nga GJEDNJ-ja ta shlyejë aplikacionin nga lista e lëndëve në përputhje me nenin 37 paragrafi 1 të KEDNJ-së dhe Rregullin 62A të Rregullores së Gjykatës. Për dallim nga ujdia miqësore, e cila nuk kërkon njohje eksplicite të shkeljes së Konventës nga ana e Qeverisë, me deklaratë të njëanshme, Qeveria në mënyrë të qartë pranon se ka pasur shkelje të KEDNJ-së në rastin e aplikantit, me ç'rast e merr përgjegjësinë të sigurohet dëmshpërblim adekuat dhe nëse një gjë e këtillë është përkatëse, të ndërmerren masa tjera të nevojshme për shmangien e shkeljes.

³⁰ Resolution Res (2004)3 of the Committee of Ministers on judgments revealing an underlying systemic problem (adopted by the Committee of Ministers on 12 May 2004 at its 114th Session). Me këtë Rezolutë Gjykata thirret “të identifikojë, në masën më të madhe të mundshme, çka është ajo që në aktgjykimet e saj në të cilat është gjetur shkelja e Konventës, mund të llogaritet për problem themelor, sistematik dhe zgjidhja e këtij problemi, veçanërisht kur është e besueshme se ajo inicion aplikime të shumta që t'u ndihmojë shteteve në gjetjen e zgjidhjeve përkatëse dhe Komitetit të Ministrave gjatë mbikëqyrjes së ekzekutimit të aktgjykimeve”.

Monitorimi i procesit të ekzekutimit të aktgjykimeve zhvillohet në intervale të caktuara kohore të kontrollit, të cilat në mënyrë të qartë janë specifikuar në Rregullin 7. Në përputhje me praktikën e vendosur, të gjitha lëndët vendosen në agjendën e secilit prej takimeve të veçanta për të drejtat e njeriut (të ashtuquajtura takime DH) të Komitetit, kështu derisa nuk mbyllet mbikëqyrja mbi ekzekutimin e tyre, përveç nëse ai nuk vendos ndryshe, duke e pasur parasysh progresin e procesit të ekzekutimit. Shqyrtimi i ekzekutimit të një lënde të caktuar në debat publik bëhet sipas iniciativës së ndonjë shteti anëtar të Këshillit të Evropës ose sipas iniciativës së Sekretariatit të Komitetit, ndërsa duhet të përmbajë shkaqe mjaftueshëm të justifikuar. Edhe pse mungojnë kriteret e qarta në lidhje me atë se kur mund të paraqitet një iniciativë e këtillë, është e qartë se kjo ndërlidhet me progresin, përkatësisht me mungesën e progresit në ekzekutimin e aktgjykimit konkret dhe nevojën që të kërkohen drejtime ose mbështetje nga Komiteti i Ministrave në lidhje me procesin e ekzekutimit, veçanërisht për çështjet e ndjeshme.

Sic theksohet edhe në vet titullin e kësaj pjese, sistemi i mbikëqyrjes së KM-së, i inkorporuar me reformën e vitit 2011, është “me dy korsi”, me qëllim të priorizimit të lëndëve që i mundësojnë Komitetit të Ministrave të fokusohet në lëndë më komplekse dhe në këtë mënyrë të arrihet një ekzekutim më i shpejtë dhe më efikas i aktgjykimeve të Gjykatës. Sipas këtij sistemi, pjesa më e madhe e lëndëve të “thjeshta” do të bënin pjesë tek **mbikëqyrja standarde** me ndërhyrje minimale të Komitetit të Ministrave (“korsia e parë”). Për dallim nga kjo, **mbikëqyrja e fuqizuar** (“korsia e dytë”) kryesisht është rezervuar për lëndët në të cilat nevojiten masa urgjente individuale, pilot-aktgjykime, lëndë në të cilat Gjykata ose Komiteti i Ministrave kanë identifikuar probleme të mëdha strukturore apo probleme komplekse, si dhe lëndë ndërshtetërore.³¹

Për më tepër, lëndët të cilat fillimisht janë vendosur në kategorinë “të thjeshta” dhe prandaj bëjnë pjesë në mbikëqyrjen standarde, më vonë mund të transferohen në mbikëqyrjen e fuqizuar, nëse ekzekutimi bëhet më kompleks.³² Mbikëqyrja e fuqizuar nënkupton një qasje proaktive nga ana e Komitetit të Ministrave, i cili ka një qasje më intensive mbikëqyrëse, me qëllim që t’u ndihmojë shteteve që ta identifikojnë përmbajtjen e masave të ekzekutimit dhe kur një gjë e këtillë është e domosdoshme, të bëjnë presion mbi shtetin konkret që një orë e më parë ta respektojë aktgjykimin në fjalë.

Klasifikimin e këtillë të lëndëve e bën Komiteti i Ministrave, i cili mund të vendos që një lëndë e caktuar të riklasifikohet sipas iniciativës së një shteti anëtar të Këshillit të Evropës ose me iniciativë të Sekretariatit, e cila mund të paraqitet në cilëndo qoftë fazë të procedurës së mbikëqyrjes mbi ekzekutimin. Ngjashëm me këtë, lënda, ekzekutimi i së cilës ka qenë me “mbikëqyrje të fuqizuar”, rrjedhimisht mund të kalojë në “mbikëqyrje standarde”, kur zhvillimi pozitiv i ngjarjeve në kuadër të procesit kombëtar të ekzekutimit nuk e vë në dukje nevojën e mëtutjeshme të “mbikëqyrjes së fuqizuar”. I këtillë është rasti kur KM-ja është e kënaqur nga plani i veprimit i prezantuar ose nga shkalla e implementimit të tij, përkatësisht

³¹ Supervision of the execution of judgments of the European Court of Human Rights: procedure and working methods for the Committee of Ministers' Human Rights meetings, paragrafi 8 (a) *Ministers' Deputies / Rapporteur Groups GR-H Rapporteur Group on Human Rights GR-H(2016)2-final*, 30 March 2016

³² Shih: Information document CM/Inf/DH(2010)45 final, 7 December 2010 (https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016804a3e07).

kur shteti do t’i tejkalojë barrierat kryesore të cilat kanë ekzistuar në procesin e ekzekutimit të ndonjë aktgjykimi konkret.

Në kundërshtim me këtë, transferimi nga “mbikëqyrja standarde” në “mbikëqyrje të fuqizuar” është i mundshëm, kryesisht me iniciativë të Sekretariatit, për shkak të mungesës së planit të veprimit, përkatësisht raportit të veprimit, gjatë divergjencave midis shtetit dhe Sekretariatit sa i përket përmbajtjes së planit të veprimit, përkatësisht raportit të veprimit (me qëllim që KM-ja të ofrojë drejtime më esenciale dhe në këtë mënyrë të kontribuojë dhe ta ndihmojë procesin e ekzekutimit), si edhe në rastin e vonës serioze të implementimit të masave të parashikuara me planin e veprimit.³³

“Mbikëqyrja e fuqizuar” mundëson që procesi i ekzekutimit të monitorohet për së afërmi dhe për këtë shkak ai zbatohet përmes miratimit të akteve (vendimeve dhe/ose rezolutave të përkohshme) me të cilat manifestohet kënaqësia, inkurajimi ose shqetësimi dhe/ apo ofrohen sugjerime ose rekomandime të caktuara në lidhje me masat e caktuara për ekzekutim. Ndërhyrjet varësisht nga rrethanat mund të kenë edhe formë tjetër, si për shembull, deklaratë nga ana e kryetarit të Komitetit të Ministrave ose ngjashëm, e cila u dërgohet shteteve në fjalë.

1.6. Aktet e Komitetit të Ministrave

Në parim, Komiteti i Ministrave mund të miratojë dy lloje të akteve në procesin e mbikëqyrjes së ekzekutimit si vijon:

- 1) **rezoluta e përkohshme** – e cila miratohet gjatë implementimit të mbikëqyrjes mbi ekzekutimin e ndonjë aktgjykimi të caktuar ose kushteve të ujdisë miqësore, posaçërisht me qëllim që të sigurohen informacione që kanë të bëjnë me progresin e ekzekutimit ose, aty ku një gjë e këtillë është përkatëse, në mënyrë që të manifestohet shqetësim dhe/ose të ofrohen propozime në lidhje me ekzekutimin (Rregulli 16)³⁴, si dhe
- 2) **rezoluta përfundimtare (finale)** – e cila miratohet pas konstatimit se shteti i ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për respektimin e aktgjykimit ose për ekzekutimin e kushteve të ujdisë miqësore, dhe pas kësaj KM-ja do të konkludojë se ai i ka kryer autorizimet e veta konform nenit 46 paragrafi 2 ose nenit 39 paragrafi 4 të KEDNJ-së (Rregulli 17).

³³ Me fjalë të tjera, kur shteti nuk do të paraqes plan të veprimit, përkatësisht raport të veprimit në periudhë prej 6 (gjashtë) muajsh pas aktgjykimit përfundimtar të GJEDNJ-së, atëherë Sekretariati dërgon kujtim (memento), ndërsa nëse një gjë e këtillë nuk e bën as në periudhën plotësuese prej 3 (tre) muajsh pas pranimit të kujtimit (mementos), Sekretariati do të dërgojë propozim që ekzekutimi i lëndës konkrete të monitorohet nën “mbikëqyrje të fuqizuar”.

³⁴ Përveç kësaj, rezoluta e përkohshme miratohet edhe atëherë kur çështjet referohen për interpretimin e aktgjykimit (Rregulli 10, paragrafi 3), duke e pasur parasysh se ekziston mundësia që Komiteti i Ministrave t’i drejtohet GJEDNJ-së për interpretimin e aktgjykimit konkret, çdoherë kur ajo, në kuptimin e nenit 46 paragrafi 3 të Konventës, konsideron se mbikëqyrja e ekzekutimit të aktgjykimit përfundimtar është penguar ose vështirësuar për shkak të problemeve të interpretimit të aktgjykimit (Rregulli 10, paragrafi 1).

Pas paraqitjes së raportit përfundimtar të veprimit nga ana e shtetit në fjalë në të cilin theksohet se shteti konsideron se janë ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për ekzekutimin e aktgjykitimit dhe ai ofron një justifikim përkatës për shkaqet për të cilat është i mendimit se nuk nevojiten masa të mëtejshme, fillon të rrjedhë periudha prej 6 (gjashtë) muajsh në të cilën shtetet anëtare të tjera ose Sekretariati mund të paraqesin komente të caktuara në lidhje me çështjen e mbylljes së lëndës. Pasi që shtetet anëtare dhe Sekretariati do të pajtohen se masat e parashikuara dhe të ndërmarrë nga ana e shtetit janë të mjaftueshme, Sekretariati do t'i propozojë Komitetit të Ministrave ta miratojë rezolutën përfundimtare me miratimin e së cilës procesi i mbikëqyrjes së ekzekutimit konsiderohet si i kryer.

Së këtejmi, përveç rezolutave përfundimtare dhe të përkohshme, Komiteti mund të miratojë edhe **vendime të tjera** përmes të cilave ai merr një qëndrim të caktuar ose ofron drejttime të caktuara në lidhje me hapat e mëtejshëm të cilat priten të ndërmerren nga ana e shtetit në funksion të ekzekutimit efikas dhe mbylljes së suksesshme të lëndës konkrete, përkatësisht grupit të lëndëve.

Me Rregullin 11 të Rregullave për mbikëqyrjen e ekzekutimit, mes tjerash, përcaktohet edhe **procedura në rast të shkeljes së detyrimeve**, e cila, sipas rregullit, iniciohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Kjo është përcaktuar në nenin 46 paragrafi 4 të KEDNJ-së, dhe siç u theksua edhe paraprakisht, përcaktohet mundësia Komiteti lëndën t'ia referojë Gjykatës me qëllim që ajo të prononcohet nëse shteti përgjegjës i ka përbushur detyrimet e aktgjykitimit.

1.7. Pjesëmarrja e aplikantëve dhe e subjekteve të tjera në mbikëqyrjen e ekzekutimit

Është jashtëzakonisht e rëndësishme që krahas shtetit i cili i propozon, miraton dhe zbaton masat përkatëse për ekzekutimin e aktgjytimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në atë proces, një kontribut aktiv mund të ofrojë edhe **vet aplikantët si palë të dëmtuara**, të cilët kanë të drejtë të dorëzojnë parashitësë (komunikim) në lidhje me pagesën e dëmshpërblimit të drejtë ose me ndërmarrjen e masave të veçanta (Rregulli 9, paragrafi 1).

Njëherësh, Komiteti i Ministrave i shqyrton edhe parashitësën e parashtruarë nga **organizatat joqeveritare dhe nga institucionet kombëtare për avancimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut**, në lidhje me ekzekutimin e aktgjytimeve, në përputhje me nenin 46 paragrafi 2 të Konventës (Rregulli 9, paragrafi 2), parashitësën e **organizatave ndërkombeve ose të organeve apo agjencive të tyre**, objektivat dhe aktivitetet e të cilave përfshijnë mbrojtje ose avancim të të drejtave të njeriut, sa u përket çështjeve që kanë të bëjnë me ekzekutimin e aktgjytimeve konform nenit 46 paragrafi 2 të Konventës, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat e tyre (Rregulli 9, paragrafi 3), si dhe parashitësën e **institucionit ose organit, të cilit i është mundësuar të ndërhyjë në procedurën para Gjykatës**, në lidhje me ekzekutimin e aktgjytimeve konform nenit 46 paragrafi 2 të Konventës ka qenë në të

gjitha rastet (**si Komisioneri i të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës**) dhe në ato raste që kanë të bëjnë me autorizimet e Gjykatës (sa i përket çdo institucioni ose organi tjetër) (Rregulli 9, paragrafi 4).

Për shembull, në praktikën e deritanishme të monitorimit të ekzekutimit të aktgjytimeve maqedonase, vetëm në disa raste vërehet përfshirje më e madhe në procesin e ekzekutimit përmes komunikimit me Komitetin e Ministrave të vet aplikantëve (sa i përket aktgjykitimit *Mitet³⁵*), përkatësisht përfaqësuesit e tyre (për aktgjykitimin *Shoqata e Qytetarëve "Radko" dhe Paunkovski³⁶*) ose përfshirja aktive e organizatave joqeveritare (për aktgjykitimet *El Masri³⁷* dhe *Strezovski dhe të tjerët³⁸*). U dëshmuva se komunikimi i këtyre aplikantëve dhe i palëve tjera të interesuara, përfshirë këtu edhe organizatat joqeveritare të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes të të drejtave të njeriut, në mënyrë plotësuese mund ta intensifikojë dialogun e shtetit të paditur dhe përgjegjës me Komitetin e Ministrave dhe atë ta stimulojë që të jetë akoma më i angazhuar në ndërmarrjen e masave dhe në raportimin për të njëjtat pranë KM-së përmes paraqitjes së planeve të veprimeve të rishikuara.

³⁵ Shih parashitësën e aplikantit të dytë: [https://hudoc.exec.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:%7B%22Mitovi%22%7D%22%7D%22%7B%22EXECLanguage%22:%7B%22ENG%22%7D%7D%22%7B%22EXECState%22:%7B%22MKD%22%7D%7D%22%7B%22EXEClntifier%22:%7B%22DDH-DD\(2020\)554E%22%7D%7D%7D%7D](https://hudoc.exec.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:%7B%22Mitovi%22%7D%22%7D%22%7B%22EXECLanguage%22:%7B%22ENG%22%7D%7D%22%7B%22EXECState%22:%7B%22MKD%22%7D%7D%22%7B%22EXEClntifier%22:%7B%22DDH-DD(2020)554E%22%7D%7D%7D%7D)

³⁶ Shih parashitësën e përfaqësuesit të Shoqatës "Radko" nga viti 2014: [https://hudoc.exec.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:%7B%22Radko%22%7D%22%7D%22%7B%22EXECLanguage%22:%7B%22ENG%22%7D%7D%22%7B%22EXECState%22:%7B%22MKD%22%7D%7D%22%7B%22EXEClntifier%22:%7B%22DDH-DD\(2014\)373E%22%7D%7D%7D%7D](https://hudoc.exec.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:%7B%22Radko%22%7D%22%7D%22%7B%22EXECLanguage%22:%7B%22ENG%22%7D%7D%22%7B%22EXECState%22:%7B%22MKD%22%7D%7D%22%7B%22EXEClntifier%22:%7B%22DDH-DD(2014)373E%22%7D%7D%7D%7D)

³⁷ Sa i përket ekzekutimit të këtij aktgjykitimi me parashitësë të veta u prononcua organizata joqeveritare "Iniciativa për Drejtësi të Shoqërisë së Hapur" (Open Society Justice Initiative): [https://hudoc.exec.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:%7B%22ElMasri%22%7D%22%7D%22%7B%22EXECLanguage%22:%7B%22ENG%22%7D%7D%22%7B%22EXECState%22:%7B%22MKD%22%7D%7D%22%7B%22EXEClntifier%22:%7B%22DDH-DD\(2019\)1432E%22%7D%7D%7D%7D](https://hudoc.exec.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:%7B%22ElMasri%22%7D%22%7D%22%7B%22EXECLanguage%22:%7B%22ENG%22%7D%7D%22%7B%22EXECState%22:%7B%22MKD%22%7D%7D%22%7B%22EXEClntifier%22:%7B%22DDH-DD(2019)1432E%22%7D%7D%7D%7D)

³⁸ Të dyja parashitësën nga organizata joqeveritare "No Pasaran" nga muaji shtator i vitit 2020 dhe nga muaji shkurt i vitit 2021 janë të qasshme në: [https://hudoc.exec.coe.int/ENG#%7B%22fulltext%22:%7B%22Strezovski%22%7D%22%7D%22%7B%22EXECLanguage%22:%7B%22ENG%22%7D%7D%22%7B%22EXECState%22:%7B%22MKD%22%7D%7D%22%7B%22EXEClntifier%22:%7B%22DDH-DD\(2021\)188E%22%7D%7D%7D%7D](https://hudoc.exec.coe.int/ENG#%7B%22fulltext%22:%7B%22Strezovski%22%7D%22%7D%22%7B%22EXECLanguage%22:%7B%22ENG%22%7D%7D%22%7B%22EXECState%22:%7B%22MKD%22%7D%7D%22%7B%22EXEClntifier%22:%7B%22DDH-DD(2021)188E%22%7D%7D%7D%7D)

II. MASA PËR EKZEKUTIMIN E AKTGJYKIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

II.1. Llojet e masave për ekzekutimin e aktgjykimeve – shënime të përgjithshme dhe kuadri juridik kombëtar

Siç u theksua më lartë, krahas detyrimit për pagesën e **dëmshpërblimit të drejtë** që i është përcaktuar aplikantit nga ana e Gjykatës brenda afatit të përcaktuar nga Gjykata, shtetet të cilat e kanë shkelur Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut kanë detyrim dhe prej të njëjtave pritet të ndërmarrin dy lloje të masave në procesin e ekzekutimit të aktgjykimeve të GJEDNJ-së, si vijon: masa të veçanta (individuale) që kanë të bëjnë me vet aplikantin, ndërsa kur një gjë e këtillë është përkatëse, edhe masa të përgjithshme (gjenerale) në rendin juridik vendor me qëllim që t'i vihet fund shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe të shmangen efektet e saj.³⁹

Përndryshe, me dëmshpërblim të drejtë nënkuptohet një shumë e caktuar monetare e cila caktohet nga ana e GJEDNJ-së në përputhje me nenin 41 të Konventës si kompensim të dëmit të pësuar jomaterial dhe/ose në një numër më të vogël të lëndëve, kompensim të dëmit material të cilin e ka pësuar aplikanti nga shkelja e konstatuar e Konventës. Përveç kësaj, kompensimi i drejtë, në vetvete mund ta ngërthejë edhe koston e shpenzimeve të krijuara në lidhje me procedurën vendase, si dhe ato të shkaktuara nga procedura e ngritur sipas aplikacionit para GJEDNJ-së. Në disa lëndë të caktuara, Gjykata ka mundësi që plotësisht ta përjashtojë nevojën e pagesës së dëmshpërblimit të drejtë, duke gjetur se konstatimi i shkeljes vetvetiu e nënkupton kënaqjen e drejtë (satisfaksion moral) të aplikantit dhe së këtejmi Gjykata nuk ka konstatuar nevojë për përcaktimin e saj.

Në parim, **masat individuale për ekzekutimin e aktgjykimeve** çdoherë kanë të bëjnë dhe i referohen aplikantit dhe kanë për qëllim rikuperimin e pasojave të cilat i ka pësuar nga ndonjë shkelje e caktuar e Konventës, e cila është konstatuar në aktgjykimin e GJEDNJ-së. Ndërmarrja e tyre ndërlihet me faktin se pasojat e shkeljes nuk mund të eliminohen çdoherë në mënyrë përkatëse përmes pagesës së dëmshpërblimit të drejtë në shumën e caktuar nga GJEDNJ-ja apo me vet konstatimin e shkeljes së KEDNJ-së. Pikërisht për këto shkaqe, në këto lëndë është e nevojshme të ndërmerren masa të caktuara përmes të cilave do të sigurohet anulimi i plotë i shkeljes dhe *restitutio in integrum*, përkatësisht kthimi në gjendjen e njëjtë e cila ka ekzistuar para çastit të shkaktimit të shkeljes, siç është për shembull, kthimi i tokës së shpronësuar,⁴⁰ kthimi i objektit,⁴¹ lëshimi në liri i personit i cili është mbajtur pa bazë në paraburgim, pavarësisht aktgjykimit lirues (aktgjykim pafajësie)⁴² ose kthimi i ndonjë personi në funksion shtetëror.⁴³

³⁹ *Ilgar Mammadov v. Azerbaijan [GC]*, no. 15172/13, § 147, 29 May 2019

⁴⁰ *Papamichalopoulos v. Greece* (Article 50), no. 14556/89, § 38, 31 October 1995

⁴¹ *Brumarescu v. Romania* (Article 41), no. 28342/95, § 22, 23 January 2001

⁴² *Assanidze v. Georgia [GC]*, no. 71503/01, § 203, ECHR 2004-II

⁴³ *Oleksandr Volkov v. Ukraine*, no. 21722/11, § 208, ECHR 2013-I

Përveç kësaj, varësisht nga rrethanat e lëndës konkrete, në një numër të madh të lëndëve kjo mund të nënkuptojë **përsëritje, përkatësisht hapje të sërishme të procedurës kontestuese gjyqësore** për të cilën GJEDNJ-ja ka konstatuar se është zbatuar në kundërshtim me garancitë për gjykim të drejtë të cilat i parashikon neni 6 i KEDNJ-së (e drejta e gjykitimit të drejtë)⁴⁴ ose në raste më të rralla, madje edhe gjatë shkeljes së dispozitave tjera të Konventës.

Në nivel kombëtar, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kjo materie është rregulluar me Ligjin për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut⁴⁵, në të cilin në mënyrë të qartë specifikohet se ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës u sigurohet ankuesve përmes pagesës së mjeteve të caktuara, si dëmshpërblim i drejtë, aprovim dhe ndërmarrje e masave të veçanta dhe të përgjithshme, me qëllim të shmangies së shkeljes dhe pasojave të cilat janë shfaqur nga e njëjta, si dhe të shkaqeve që kanë çuar deri në paraqitjen e ankesave në Gjykatë dhe parandalimi përkatës i shkeljeve të njëjta apo të ngjashme (neni 2) dhe se ekzekutimi është i detyrueshëm për shtetin (neni 3), dhe për këtë sigurohen mjete nga Buxheti (neni 4).

Me këtë ligj janë përfshirë vendimet e Gjykatës në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke i përfshirë aktgjykimet, vendimet për palejueshmërinë e ankesës, vendimet për shlyerjen e ankesës nga lista e lëndëve të Gjykatës për shkak të ujdisë së arritur miqësore ose për shkak të prononcimit të deklaratës së njëanshme nga ana e shtetit me të cilën pranohet shkelja e kryer (neni 5, pika 6)⁴⁶.

Në këtë ligj masat e veçanta rekomandohen varësisht nga shkelja e konstatuar dhe gjendja e ankuesit në kohën e kryerjes së shkeljes (neni 25 paragrafi 1). Ato janë specifikuar si masa të cilat shteti si palë kontraktuese e Konventës mund t'i miratojë në rendin juridik vendas me qëllim të shmangies së shkeljes konkrete të konstatuar nga Gjykata ndaj ankuesit, si dhe për shmangien e pasojave eventuale nga shkelja. Shteti është i lirë t'i përzgjedh mjetet me të cilat do t'i kryej detyrimet e veta ligjore (neni 5, pika 12).

Nga ana tjetër, në lidhje me **masat e përgjithshme për ekzekutimin e aktgjykimeve**, parashikohet nëse me vendimin e Gjykatës përcaktohet se shkelja e konstatuar buron nga ligji, akte tjera normative ose nga praktika e subjekteve të nenit 24 paragrafi (1) të këtij ligji (organet kompetente të administratës ose jurisprudencës), iu rekomandohet të ndërmarrin masa të përgjithshme për tejkalimin e mangësisë, e cila ka qenë shkas për paraqitjen e

⁴⁴ Në lidhje me rihapjen, përkatësisht përsëritjen e procedurave sipas aktgjykimit të GJEDNJ-së, me rëndësi të jashtëzakonshme është rekomandimi Rec(2000)2 i Komitetit të Ministrave adresuar shteteve anëtare për rishikimin ose rihapjen e procedurës gjyqësore për çështje të caktuara në nivel kombëtar sipas aktgjykimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të theksuar më lartë.

⁴⁵ Ligji për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/2009), i ndryshuar me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 43/2014). Mund të shihet se ky Ligj e përdor termin ankesë dhe ankues, në vend të termit aplikacion dhe aplikant.

⁴⁶ Termi "vendim" në terminologjinë e KEDNJ nënkupton një vendim procedural, që zakonisht vendos për pranueshmërinë e ankesave, në krahasim me një aktgjykim meritore që vendos për thelbin e një çështjeje të caktuar. Ky term përdoret njëkosisht kur bëhet fjalë për vendimet që i referohen një marrëveshjeje miqësore të arritur, pra një deklaratë unilaterale të deklaruar.

ankesës në Gjykatë dhe parandalimin përkatës të shkeljeve të njëjta ose të ngjashme të konstatuara nga Gjykata (neni 26).

Ato janë specifikuar si përmbledhje të masave sistematike, ndryshime të legjislacionit, ndryshime të praktikës gjyqësore dhe administrative dhe procedime të organeve kompetente shtetërore, dhe si masa të tjera të cilat shteti i ndërmerr për tejkalimin efektiv të mangësive të përcaktuara juridike sistematike, rregullimin e pamjaftueshëm juridik, mosharmonizimin e legjislacionit vendas me dispozitat dhe standardet e KEDNJ-së dhe me standardet dhe detyrimet e aprovuara të tjera ndërkombëtare, të cilat në mënyrë kumulative e shkelin

Konventën, në përputhje me arsyetimin dhe udhëzimet e Gjykatës në aktgjykimin e miratuar (neni 5, pika 13).⁴⁷

Në të vërtetë ideja e cila qëndron në sfondin e ndërmarrjes së këtij lloji të masave ka të bëjë me parandalimin e shkeljeve të ngjashme në të ardhmen të KEDNJ-së, përkatësisht me shfaqjen e të ashtuquajturave shkelje të klonuara ose të përsëritura para GJEDNJ-së në të cilat më së shpeshti theksohen pretendime për shkelje të njëjta, përkatësisht të ngjashme, të Konventës si ato të cilat tanimë janë konstatuar nga ana e GJEDNJ-së në aktgjykimet paraprake kundër shtetit. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, kur ajo do të konstatojë se është e besueshme se shkelja e Konventës mund të paraqitet në situata të tjera të ngjashme, atëherë paraqitet nevoja për masa të përgjithshme, të cilat duhet të mbajnë llogari për grupin e individëve i cili është, përkatësisht do të ishte, i goditur nga praktika me të cilën shkelet KEDNJ-ja. Në këtë kontekst, këto masa do duhet t'i referohen praktikës së përgjithshme, me qëllim që sistemin të cilin e vendos Konventa të mos rrënohet nga numri i madh i aplikacioneve të përsëritura, të cilat rezultojnë nga shkak i njëjtë.⁴⁸

Së këtejmi, ky lloj i masave më së shpeshti nënkupton ndryshime të legjislacionit, përkatësisht ndryshime në kuadrin ligjor kombëtar dhe në kuadrin më të gjerë juridik, ndryshime në praktikën gjyqësore ose administrative, ndryshime institucionale në drejtim të vendosjes së strukturave të reja më efikase ose në drejtim të fuqizimit të kapacitetit të institucioneve ekzistuese për t'i kuptuar dhe zbatuar standardet e të drejtave të njeriut në punën e tyre të përditshme dhe shmangies së praktikave të cilat nuk korrespondojnë me jurisprudencën e GJEDNJ-së.

Përveç kësaj, janë të rëndësishme edhe masat të cilat kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes, siç janë trajnimet dhe aktivitetet edukative, por edhe publikimi i aktgjyimeve të GJEDNJ-së

⁴⁷ Përmbajtja e tyre më për së afërmi është specifikuar në nenin 27, sipas të cilit "masa të përgjithshme janë: 1) ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve dhe akteve të tjera normative për shkak të të cilave është bërë shkelja e konstatuar dhe monitorimi i zbatimit të tyre; 2) ndryshimet sa i përket procedimit të subjekteve kompetente në përputhje me ligjin; 3) sigurimi i ekspertizës juridike të projekteve ligjore; 4) aftësimi dhe përsosja profesionale e: gjyqtarëve, prokurorëve publikë, avokatëve, të punësuarve në organet e administratës shtetërore, të punësuarve në shërbimet e migracionit dhe kategorive të tjera të të punësuarve, puna e të cilëve ndërlidhet me zbatimin e ligjeve dhe akteve të tjera normative, me qëllim të zbatimit përkatës të Konventës dhe praktikës gjyqësore, të vendosur në Gjykatë dhe 5) masa të tjera të përcaktuara konform vendimit të Gjykatës për parandalimin e shkeljeve të Konventës me qëllim të shmangies së mangësive të karakterit sistematik dhe sigurim të dëmshpërblimit për pasojat e shkeljeve."

⁴⁸ *Baybaşın v. the Netherlands*, no. 13600/02, § 79, 6 July 2006

në gjuhën zyrtare të shtetit përgjegjës dhe dërgesa (shpërndarja) e tyre deri te autoritetet (organet) e interesuara të cilat kanë qenë të përfshira në miratimin e vendimeve kontestuese vendase që duhet të marrin pjesë në procesin e ekzekutimit të tyre.

Marrë në përgjithësi, ndërmarrja e masave të përgjithshme efektive duhet të ketë ndikim pozitiv mbi fuqizimin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut dhe zbatimin e standardeve të Konventës në nivel kombëtar, si dhe mbi reduktimin e numrit të aplikacioneve ndaj të cilave duhet të veprojnë Gjykata e Strasburgut, që është e dëshirueshme nga aspekti i fuqizimit të efikasitetit të saj.

II.2. Përzgjedhja e masave për ekzekutimin e aktgjyimeve

Në parim, aktgjykimet e GJEDNJ-së janë të natyrës deklarative dhe kanë të bëjnë me konstatimin e shkeljes së të drejtës ose lirisë së caktuar nga Konventa. Së këtejmi, ato nuk janë shumë të besueshme sa i përket natyrës dhe shtrirjes së masave të nevojshme për ekzekutimin e aktgjykimit, pavarësisht nëse bëhet fjalë për masa individuale apo të përgjithshme, kështu që këto masa, ashtu siç në të vërtetë në shumë raste ka konstatuar GJEDNJ-ja, duhet t'i identifikojnë vet shtetet.

Kjo shpjegohet me parimin e subsidiaritetit, konform të cilit shteti përgjegjës, në parim, ka **fleksibilitet gjatë përzgjedhjes së masave** të cilat do t'i ndërmarrë me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të veta nga KEDNJ-ja në lidhje me ekzekutimin e aktgjyimeve. Në këtë kuptim, theksohet se ndërmarrja e masave të përgjithshme dhe të veçanta do të varet nga diskrecioni i shtetit të interesuar, i cili duhet t'i zgjedh mjetet e nevojshme që të veprojnë konform aktgjykimit.⁴⁹ Në të vërtetë, ky diskrecion në lidhje me mënyrën e ekzekutimit të aktgjyimeve e pasqyron lirinë e zgjedhjes, e cila rezulton nga detyrimi primar i shteteve të cilat janë palë kontraktuese të Konventës që t'i garantojnë të drejtat dhe liritë e Konventës në përputhje me nenin 1 të KEDNJ-së.⁵⁰

Megjithatë, kjo përzgjedhje nuk është plotësisht e lirë, kështu që shtrirja e masave determinohet nga motivet për shkak të të cilave është konstatuar shkelja,⁵¹ përkatësisht shteti përgjegjës është i lirë t'i zgjedh mjetet me të cilat do t'i përmbush detyrimet e veta ligjore nga neni 46 i KEDNJ-së, me kusht që ato mjete të jenë **kompatibile me gjetjet që i përmban aktgjykimi i Gjykatës**.⁵² Njëkohësisht, edhe në praktikën e pasur të Komitetit të Ministrave e cila zhvillohet në raport me shtetet e tjera në raste të ngjashme, autoritetet kombëtare mund të gjejnë zgjidhje solide për masat e ekzekutimit të cilat KM-ja do t'i kërkojë apo do t'i presë në procesin e ekzekutimit të aktgjykimit konkret ose aktgjyimeve grupore.

⁴⁹ Rregulli 6 paragrafi 2 i Rregullave të KM-së për mbikëqyrjen e ekzekutimit

⁵⁰ *Papamichalopoulos and Others v. Greece* (Article 50), 31 October 1995, § 34, Series A no. 330-B

⁵¹ *Ilgar Mammadov v. Azerbaijan [GC]*, no. 15172/13, § 187, 29 May 2019

⁵² *Scozzari and Giunta v. Italy [GC]*, nos. 39221/98 and 41963/98, § 249, ECHR 2000-VIII

Së këtejmi, në rrethana tjera të veçanta, Gjykata përpiqet ta specifikojë llojin e masave të cilat mund të ndërmerren me qëllim që t'i vihet fund shkeljes për të cilën ka konstatuar se ekziston,⁵³ ndërkaq në aktgjykimet e veta përfshin indicie të cilat janë relevante për procesin e ekzekutimit dhe për masat konkrete të cilat duhet të ndërmerren.

Megjithatë, duke e marrë parasysh balancin institucional midis Komitetit të Ministrave sipas Konventës dhe përgjegjësinë e shteteve në këtë proces, zgjedhja përfundimtare e masave të cilat duhet të ndërmerren janë në duart e shtetit, nënkuptohet në mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave.⁵⁴

Në këtë kuptim, lidhur me çështjen se shteti a i përmbush detyrimet e veta nga neni 46 paragrafi 1 i KEDNJ-së, nuk është relevante përfshirja ose mospërfshirja e deklaramit eksplicit në aktgjykimin i cili është relevant për ekzekutimin, por a korrespondojnë masat e ndërmarra nga shteti përgjegjës me konkluzionet dhe me frymën e aktgjykimit të Gjykatës.⁵⁵ Pikërisht ekspliciteti i drejtimit të aktgjykimit të GJEDNJ-së në lidhje me ekzekutimin, mund ta shmang fleksibilitetin i cili i nevojitet KM-së gjatë zbatimit të mbikëqyrjes mbi masat e ndërmarra, në bazë të informacioneve të siguruar nga shteti, duke e pasur parasysh zhvillimin e gjendjes së aplikantit, si dhe cilat masat duhet të jenë të zbatueshme, në kohë të duhur, adekuate dhe të mjaftueshme.⁵⁶

⁵³ *Suso Musa v. Malta*, no. 42337/12, § 120, 23 July 2013

⁵⁴ *Ilgar Mammadov v. Azerbaijan [GC]*, no. 15172/13, § 182, 29 May 2019

⁵⁵ *ibid*, § 186

⁵⁶ *ibid*, § 184

III. KUADRI DHE PRAKTIKA JURIDIKE DHE INSTITUCIONALE KOMBËTARE E EKZEKUTIMIT TË AKTGJYKIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

III.1. *Struktura institucionale për ekzekutimin e aktgjytimeve të GJEDNJ-së në nivel kombëtar*

Krahas kompetencave për përgatitjen e mbrojtjes, si dhe për ta përfaqësuar dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë për ta avokuar shtetin në procedurat para Gjykatës në rastet kur shteti është palë, si dhe krahas kompetencave që të kontraktojnë marrëveshje për zgjidhjen miqësore të lëndëve para Gjykatës dhe në emër të Qeverisë të deklarojë deklaratë të njëanshme, Byroja e Përfaqësimit të Shtetit para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në tekstin në vijim: “Byroja e Përfaqësimit”, “Byroja”) e cila funksionon si organ në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë në krye të së cilës është drejtori i Byrosë – Agjent i Qeverisë, ka rol të drejtpërdrejtë në ekzekutimin e aktgjytimeve. Ky dyzim i funksioneve të Agjentit të Qeverisë, dhe të përfaqësuesit të shtetit para GJEDNJ-së në lëndët e iniciuara me aplikacione të paraqitura kundër shtetit, edhe si pjesëmarrës edhe si koordinator i procesit të ekzekutimit të aktgjytimeve të GJEDNJ-së në të cilat janë konstatuar shkelje, që kanë të bëjnë me rastet të cilat GJEDNJ-ja paraprisht i ka përfaqësuar, është praktikë e zakonshme në një varg shtetesh anëtare të Këshillit të Evropës.

Kuadri përkatës juridik që ka të bëjë me statusin e Agjentit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut para GJEDNJ-së në një masë të caktuar është kompetent edhe atëherë kur bëhet fjalë për ekzekutimin e aktgjytimeve të GJEDNJ-së dhe është specifikuar në **Ligjin për Përfaqësim para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut**.⁵⁷

Në mesin e veprimeve të tjera të cilat duhet t'i ndërmarrë Byroja e Përfaqësimit të Shtetit para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në fushën e ekzekutimit bëjnë pjesë edhe: hartimi i rekomandimeve për veprime të mundshme të gjykatave vendase dhe organeve shtetërore për shkak të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës në rast të shkeljes së konstatuar të Konventës; monitorimi i realizimit të detyrimeve të gjykatave vendase dhe organeve shtetërore të cilat rezultojnë nga vendimet e Gjykatës sipas shkeljeve të konstatuara të Konventës; dërgesa e informacioneve deri te Komiteti i Ministrave pranë Këshillit të Evropës, në koordinim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, për masat e ndërmarra nga shteti për ekzekutimin e aktgjytimeve të miratuara nga Gjykata; pjesëmarrja në punën e mbledhjeve të KM-së kur shqyrtohen masat e ndërmarra për ekzekutimin e aktgjytimeve të Gjykatës nga ana e Shtetit, si dhe bashkëpunimi me Akademinë për Trajnimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, në edukimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve, prokurorëve publikë,

⁵⁷ Ligji për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”) nr. 67/2009, 88/2014 dhe 83/2018)

avokatëve dhe profesioneve të tjera juridike, me qëllim të ekzekutimit të aktgjyimeve dhe zbatimit të praktikës së Gjykatës si burim i së drejtës.⁵⁸

Me nenin 6 të Ligjit për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut themelohet **Komisioni Ndërinstitucional për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut**, fushëveprimi i të cilit në detaje është rregulluar me Rregulloren e Punës së Komisionit Ndërinstitucional për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në tekstin në vijim: Rregullorja e Punës së Komisionit Ndërinstitucional, Rregullorja).

Siç është theksuar në nenin 11 të Ligjit dhe nenin 3 të Rregullores, Komisioni Ndërinstitucional i kryen punët që kanë të bëjnë me: 1) analizën e aktgjyimeve të Gjykatës të miratuara në lëndët e paraqitura kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut me qëllim të përcaktimit të shkaqeve të cilat kanë çuar deri në shkelje; 2) rekomandimin e masave të veçanta dhe të përgjithshme të autoriteteve kompetente shtetërore për shmangien e shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe të pasojave nga e njëjta; 3) dhënien e propozimeve për përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut; 4) monitorimin e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës; 5) sigurimin dhe shkëmbimin e informacioneve dhe të dhënave në fushën e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës, si dhe 6) monitorimin e sistemit ekzistues të ekzekutimit të vendimeve dhe propozimin e masave për përmirësimin e tij.

Me KNI-në udhëheq Ministri i Drejtësisë,⁵⁹ i cili i thërret mbledhjet dhe kryeson me to, merr pjesë në punën e tij, vendos dhe kujdeset për implementimin në kohën e duhur të konkluzioneve të tij, siç është ndërmarrja e masave në rast të mosveprimit ndaj akteve të cilat i miraton ai.⁶⁰ Edhe pse Agjenti i Qeverisë sipas funksionit është vetëm anëtar i Komisionit Ndërinstitucional, megjithatë, Agjenti edhe më tutje e ka rolin kryesor në punën e tij, veçanërisht duke e pasur parasysh faktin se të gjitha punët profesionale dhe administrative të Komisionit Ndërinstitucional i kryen Byroja e Përfaqësimit (neni 7 i Ligjit).

Roli kryesor i Byrosë shihet edhe në dispozitën ligjore në të cilën është përcaktuar se “Byroja menjëherë, ndërkaq më së voni në afat prej 3 (tre) muajsh pas dërgesës së njoftimit për vendimin përfundimtar të Gjykatës, e njofton KNI-në për vendimin e miratuar, për shkeljet e konstatuara dhe propozon masa të mundshme të përgjithshme dhe të veçanta për shmangien e shkeljeve të konstatuara në vendimin.”⁶¹ Në përputhje me këtë, pas analizës së vendimit dhe pas shqyrtimit të masave të propozuara nga ana e Byrosë, Komisioni Ndërinstitucional “përpilon rekomandim dhe ua dërgon organeve kompetente shtetërore, njërive të vetëqeverisjes lokale, gjyqësorit dhe Prokurorisë Publike, që të ndërmarrin masa përkatëse, të përgjithshme dhe të veçanta, për shmangien e mundshme të shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe parandalimin e shfaqjes së shkeljeve të njëjta ose të ngjashme”.⁶²

⁵⁸ Neni 4 i Ligjit, ibid

⁵⁹ Neni 10 i Ligjit

⁶⁰ Neni 4 paragrafi 1 i Rregullores së Punës të Komisionit Ndërinstitucional

⁶¹ Neni 23 i Ligjit për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ-së

⁶² Neni 24 (1) i Ligjit

Përbërja e Komisionit Ndërinstitucional u ndryshua dhe plotësua në vitin 2014.⁶³ Kështu që numri i përfaqësuesve të pushtetit ekzekutiv të cilët janë pjesë e përbërjes së tij u reduktua dhe tani anëtarë janë funksionarët të cilët udhëheqin me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe me Ministrinë e Financave,⁶⁴ ndërsa nga anëtarësia janë përjashtuar ministrat e tjerë të cilët ishin pjesë e përbërjes së këtij Komisioni. Nga ana tjetër, në Komision janë përfshirë më shumë përfaqësues të sistemit të jurisprudencës kështu që krahas kryetarit të Këshillit Gjyqësor, kryetarit të Gjykatës Supreme, kryetarit të Këshillit të Prokurorëve Publikë dhe Prokurorit Publik Shtetëror, sipas funksionit anëtarë të KNI-së janë edhe: kryetari i Gjykatës Kushtetuese, kryetarët e katër gjykatave të apelit (në Shkup, Shtip, Manastir dhe Gostivar), si dhe kryetari i Gjykatës së Lartë Administrative.⁶⁵ Përbërja e zgjeruar ka për qëllim të mundësojë ekspertizë më të madhe dhe inkluzivitet në punën e KNI-së, si dhe efikasitet më të madh në procesin e ekzekutimit të aktgjyimeve të GJEDNJ-së, meqë me këtë sigurohet involvimi i drejtpërdrejt në ballafaqimin me gjendjet dhe hartimin e masave dhe rekomandimeve që kanë të bëjnë me ekzekutimin nga ana e përfaqësuesve më të lartë të sistemit të jurisprudencës, të cilët më vonë duhet të përfshihen në implementimin e këtyre masave dhe rekomandimeve.⁶⁶

Përndryshe, detyrat konkrete të anëtarëve të KNI-së janë përcaktuar në nenin 4 paragrafin 2 të Rregullores së punës së Komisionit Ndërinstitucional. Përveç kësaj, me qëllim të përforsimit të ekspertizës për çështje që janë në kompetencë të KNI-së, ai ka mundësi me vendim të formojë trupa punues (neni 6 paragrafi 1 i Rregullores), përkatësisht trupa të përkohshëm punues (neni 6 paragrafi 2 i Rregullores).⁶⁷ Megjithatë, duhet të theksohet se këto dispozita në të vërtetë akoma nuk janë “jetësuar” meqë deri më tani ky Komision nuk ka formuar ndonjë trup të këtyre punës.

Komisioni Ndërinstitucional vendos me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit në formë të konkluzioneve të cilat i miraton pas përfundimit të diskutimit për çdo çështje ose për ndonjë material të veçantë për të cilin është diskutuar në mbledhje (neni 21 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores).

⁶³ Shih Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 43/2014).

⁶⁴ Neni 2 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 43/2014), me të cilin ndryshohet neni 8 paragrafi 1 i Ligjit për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 67/2009).

⁶⁵ Ibid

⁶⁶ Po ashtu, për sigurimin e punës efikase të Komisionit parashikohet prezencë e detyrueshme e anëtarëve të tij, ndërsa zëvendës anëtarët nuk e kanë të drejtën e votës gjatë përcaktimit të shumicës për vendimarrje. Shih nenin 2 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, që është theksuar më lartë.

⁶⁷ Trupat punues mund të përfshijnë edhe anëtarë nga radhët e përfaqësuesve të institucioneve dhe organeve përkatëse për çështje nga fusha e kompetencës së tyre (neni 6 paragrafi 4 i Rregullores). Ato hartojnë propozim-konkluzione të cilat duhet t'i miratojë Komisioni Ndërinstitucional dhe përmbajnë masa konkrete, detyra pune dhe obligime, përkatësisht rekomandime për organet, si dhe afate dhe drejtime për mënyrën e kryerjes së tyre, ndërsa vetëm në rast se trupi punues për shkaqe nga më të ndryshmet nuk mund të marr qëndrim ose ta përcaktojë propozimin për çështje të caktuara, atëherë për këtë çështje vendos Komisioni Ndërinstitucional (neni 11 paragrafi 4, 5 dhe 6 të Rregullores). Njëherësh, parashikohet se në rast të mosveprimit ndaj detyrave të përcaktuara me vendimin për formimin e trupit punues, Agjenti i Qeverisë e ka për detyrë për këtë ta njoftojë Komisionin Ndërinstitucional (neni 12 i Rregullores).

Në të vërtetë, konkluzionet janë rekomandime të llojit të vet për ndërmarrjen e aktiviteteve të caktuara në drejtim të ekzekutimit të ndonjë aktgjykimi konkret të GJEDNJ-së dhe me të njëjtat, mes tjerash, caktohet afati dhe organi kompetent për ekzekutimin e rekomandimeve që i përmban konkluzioni (neni 21 paragrafi 3 të Rregullores). Me këto rekomandime mund të kërkohet që të ndërmerret ndonjë veprim konkret (për shembull, shqyrtimi i mundësisë për vazhdimin e hetimit ose përsëritjen e ndonjë procedure të caktuar gjyqësore, në kontekst të masave individuale apo shqyrtimi i mundësisë për ndryshime ligjore, kur bëhet fjalë për masat e përgjithshme). Njëkohësisht, në të njëjtat mund të përfshihet edhe kërkesa për të dhëna, informacione dhe raportime të caktuara, të cilat do t'i vinë në ndihmë Komisionit për krijimin e masave adekuate për ekzekutimin e ndonjë aktgjykimi konkret ose për një grup të aktgjyimeve.

Në drejtim të implementimit efikas të konkluzioneve parashikohet detyrim i autoriteteve kompetente shtetërore për ekzekutimin e tyre (neni 23 paragrafi 1) në afat jo më të gjatë se 10 (dhjetë) ditë pas skadimit të afatit të parashikuar për realizimin e konkluzionit, me shkrim ta informojë KNI-në për ekzekutimin e konkluzioneve dhe për shkallën e realizimit të tyre (neni 23, paragrafi 2). Mes tjerash, është parashikuar që Byroja në bashkëpunim me anëtarët e Komisionit Ndërinstitucional dhe anëtarët e trupave punues të kujdesen për sigurimin e pasqyrës së saktë të shkallës së realizimit të konkluzioneve (neni 23, paragrafi 3) përmes hartimit të raportit për çdo 90 ditë apo sipas nevojës edhe më herët, i cili dërgohet për shqyrtim deri te i njëjti (neni 23 paragrafi 4 dhe 5). Megjithatë, duhet të pranohet se në praktikë, kryesisht, Byroja është ajo që e ofron mbështetjen e plotë profesionale dhe administrative në punën e Komisionit dhe e monitoron shkallën e realizimit të konkluzioneve të tij, por reagon edhe në mënyrë përkatëse nëse ka ndonjë ngecje në implementimin e tyre, ndërsa thuaja se nuk është vendosur praktikë e hartimit të raportit, ashtu siç e ka përcaktuar ligjvënësi.

III.2. *Funksionimi praktik i sistemit të koordinimit të procesit të ekzekutimit të aktgjyimeve të GJEDNJ-së në nivel kombëtar*

Kundrejt dispozitave ligjore të cilat u prezantuan më lartë, në të cilat në mënyrë relativisht të detajuar është përcaktuar se si duhet të zhvillohet procesi i ekzekutimit dhe cili duhet të jetë roli i faktorëve të ndryshëm brenda tij, fitohet përshtypja se **barrën më të madhe në procesin e ekzekutimit e ka Byroja e Përfaqësimit dhe Agjenti i Qeverisë**, të cilët bëjnë përpjekje të vazhdueshme në këtë proces dhe të cilët i formalizojnë të njëjtat përmes mbledhjeve dhe konkluzioneve të cilat i miraton Komisioni Ndërinstitucional.

Dinamika kohore e mbledhjeve të KNI-së është caktuar në atë mënyrë që mbledhjet sipas nevojës, ndërsa më së paku një herë në tre muaj.⁶⁸ Megjithatë, praktika tregon se nga mbledhja e parë e tij e mbajtur më 26 nëntor të vitit 2012, e deri më mbledhjen e 20-të, të mbajtur më datë 20 maj të vitit 2021, në periudhën kohore prej thuaja se tetë vjet e gjysmë,

⁶⁸ Neni 12 paragrafi 1 i Ligjit për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, i cituar më lartë.

gjithsej janë mbajtur 20 mbledhje të KNI-së që është më pak se dy mbledhje e gjysmë në nivel vjetor dhe në njëfarë mënyre nuk korrespondon me dinamikën e caktuar ligjore prej katër mbledhjeve në nivel vjetor.⁶⁹

Pavarësisht shkaqeve për thirrjen më të rrallë të mbledhjeve të Komisionit Ndërinstitucional dhe numrit të mbledhjeve të mbajtura, megjithatë mungesa e mbledhjeve nuk pasqyrohet negativisht mbi ruajtjen e vazhdimësisë së koordinimit kombëtar edhe për sa i përket zbatimit të masave për ekzekutimin e aktgjyimeve. Njëherësh, shteti edhe më tutje mban komunikim të duhur me Këshillin e Evropës duke e njoftuar për hapat dhe aktivitetet e planifikuara dhe të ndërmarra për ekzekutimin e aktgjyimeve, ndërsa në këtë drejtim merita kryesore i takon Byrosë së Përfaqësimit dhe Agjentit të Qeverisë.⁷⁰

Mesa duket qasja e ndryshuar në ekzekutimin e aktgjyimeve të GJEDNJ-së dhe vendosja e praktikës së re dhe pozitive për paraqitjen në kohë të duhur të planeve të veprimit dhe raporteve të veprimit dhe mbylljen më të shpejtë të lëndëve të caktuara dhe grupeve të lëndëve kur bëhet fjalë për dosjen e Republikës së Maqedonisë së Veriut para Komitetit datojnë që nga viti 2015 dhe 2016.

Kështu për shembull, për dallim nga viti 2015, kur për ekzekutim para Komitetit kishte madje 123 lëndë maqedonase, gjatë vitit 2016, ai miratoi tri rezoluta përfundimtare që kishin të bëjnë me gjithsej 79 lëndë, me ç'rast numri i lëndëve rrjedhëse kah fundi i vitit 2016, u reduktua në 66 lëndë. Nga ana tjetër, këto indikatorë të volitshëm të reduktimit të numrave, në masë të madhe kanë të bëjnë me atë se në muajin mars të vitit 2016, plotësisht u mbyll grupi i lëndëve *Atanasoviç dhe të tjerët*,⁷¹ që në vetvete përmban 56 çështje “të klonuara ose përsëritëse”, në të cilat u konstatua shkelja e të drejtës së gjyqimit në afat të arsyeshëm të nenit 6 nga KEDNJ-ja. Këto lëvizje pozitive u nënvizuan edhe në Raportin e Progresit të

⁶⁹ Megjithatë, duhet të merret parasysh se deri në fillimin e pandemisë së COVID-19, Komisioni Ndërinstitucional ka mbajtur më shpesh mbledhje dhe në intervale relativisht të njëjta kohore, ndërsa gjatë vitit 2020 dhe 2021 është mbajtur vetëm një mbledhje në nivel vjetor të Komisionit, me ç'rast mbledhja e 19-të nga data 8 korrik i vitit 2020, është mbajtur onlajn. Në këtë periudhë, “me qëllim të dinamikës më të madhe të procesit të ekzekutimit të aktgjyimeve të GJEDNJ-së, Byroja e Përfaqësimit, si mbështetje profesionale dhe administrative-teknike e Komisionit Ndërinstitucional, në bazë të autorizimeve të tij, në përputhje me nenin 4alinea 12 të Ligjit për Përfaqësimin e Shtetit para GJEDNJ-së... në përputhje me të cilin harton rekomandime për procedimet e mundshme të gjykatave vendase dhe autoriteteve shtetërore me qëllim të ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së në rast të shkeljes së konstatuar të KEDNJ-së nga ana e shtetit, ka lëshuar më shumë rekomandime në funksion të ekzekutimit të aktgjyimeve të GJEDNJ-së dhe ka realizuar komunikim dinamik me një sërë institucionesh për qëllimet e sigurimit të informacioneve në funksion të njoftimit të Komitetit të Ministrave për rrjedhën dhe dinamikën e ekzekutimit të aktgjyimeve dhe koordinimin e rrjedhës së procesit të ekzekutimit”. (Procesverbal nga mbledhja e 19-të e Komisionit Ndërinstitucional për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së, e mbajtur më datë 8.7.2020, fq. 1, i qasshëm në: <https://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2021/06/%D0%97%D0%B0%D0%BF%D0%B8%D1%81%D0%BD%D0%B8%D0%BA-%D0%BE%D0%B4-19-%D1%82%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D1%81%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B8%D1%86%D0%B0.pdf>

⁷⁰ Në të vërtetë, nëse monitorohet dinamika e paraqitjes së planeve të veprimit dhe raporteve të veprimit nga ana e shtetit deri te Komiteti i Ministrave, për shembull, në tre vitet e kaluara, mund të shihet se numri i paraqitur i planeve të veprimit dhe raporteve të veprimit është i ngjashëm, edhe atë prej 14 për 18 lëndë në vitin 2018, 19 për 25 lëndë në vitin 2019 dhe 17 për 29 lëndë në vitin 2020.

⁷¹ Resolution CM/ResDH(2016)35, Execution of the judgments of the European Court of Human Rights Atanasovic and others and 55 cases against “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Adopted by the Committee of Ministers on 8 March 2016 at the 1250th meeting of the Ministers’ Deputies)

Komisionit Evropian për vitin 2016. Në këtë Raport, për herë të parë pasi që monitorohet gjendja me ekzekutimin e aktgjyimeve të GJEDNJ-së, theksohet se “Byroja e Përfaqësimit para GJEDNJ-së ndërmori përpjekje të konsiderueshme që të sigurojë ekzekutim të shpejtë të aktgjyimeve të GJEDNJ-së (si “prioritet urgjent i reformave”) dhe arriti rezultate të mira” me ç’rast “vendi e reduktoi numrin e aktgjyimeve të GJEDNJ-së, numër ky i cili duhet të ekzekutohet më shumë se gjysma deri në 56.”⁷²

Tendenca e mbylljes së një numri të madh të lëndëve, ekzekutimi i të cilave është në mbikëqyrje të KM, vazhdoi edhe në vitet e ardhshme. Kështu që, ky numër është 52 në vitin 2017 dhe 2018, 35 në vitin 2019 dhe 40 në vitin 2020, prej të cilave 15 kryesore. Së këtejmi, mund të konkludojmë se kjo, në masë të madhe, i referohet reformës së mbikëqyrjes së ekzekutimit, e cila imponoi një komunikim më intensiv midis autoriteteve kombëtare dhe KM-së dhe kishte ndikim të volitshëm afatmesëm mbi efikasitetin e ekzekutimit të aktgjyimeve të GJEDNJ-së.

Nuk përjashtohet fakti se këto rezultate pozitive sa i përket ekzekutimit, në njëfarë mase mund të vihen në korrelacion edhe me punën e Komisionit Ndërinstitucional. Ky trup është vendosur në mënyrë solide normative si organ për koordinimin e procesit të përgjithshëm të ekzekutimit të aktgjyimeve të GJEDNJ-së, në përputhje me standardet ndërkombëtare të Këshillit të Evropës dhe praktikën krahasuese të shteteve tjera. Me fjalë të tjera, bëhet fjalë për specifikën e sistemit vendor meqë trupa punues të ngjashëm ndërinstitucional, brenda institucional për koordinim funksionojnë vetëm në një numër të vogël të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës siç është për shembull: Kroacia, Çekia, Polonia etj.

Jo rrallë herë, pikërisht konkluzionet dhe rekomandimet e KNI-së janë sanksionuar në tekstet e planeve të veprimeve dhe raporteve të veprimit konkret, të cilët paraqiten në funksion të njoftimit të KM-së për rrjedhën dhe progresin e ekzekutimit të lëndëve të caktuara. Megjithatë, praktika e punës së tij, tregoi se është e rekomandueshme, në të ardhmen, t’i përkushtohet vëmendje thirrjes më të rregullt dhe mbajtjes së mbledhjeve, me qëllim të formulimit në kohë të duhur dhe dërgimit të rekomandimeve deri te institucionet dhe organet kompetente dhe përshpejtimit të ekzekutimit si një proces integral.

Nga ana tjetër, dispozita ligjore me të cilën përcaktohet mbajtja e tyre më së paku një herë në tre muaj mesa duket është e tejkualar dhe praktikisht është e paqëndrueshme, veçanërisht duke e pasur parasysh se dinamika e shqyrtimit të lëndëve para KM-së shpeshherë imponon veprime të shpejta edhe në bazë ditore, kështu që nuk lihet hapësirë për shqyrtim paraprak të çdo hapi në rrugën e ekzekutimit të aktgjyimeve nga KNI-ja.

Pikërisht për shkak të mungesës së mbledhjeve, rëndësi të jashtëzakonshme ka komunikimi në bazë ditore i Byrosë së Përfaqësimit me institucionet e interesuara prej të cilave një pjesë

⁷² DOKUMENT PUNE I SHËRBIMEVE TË KOMISIONIT, Raporti për Republikën e Maqedonisë për vitin 2016, bashkëngjitur RAPORTIMIT TË KOMISIONIT ADRESUAR PARLAMENTIT EVROPIAN, KËSHILLIT, KOMITETIT EVROPIAN EKONOMIK-SOCIAL DHE KOMITETIT TË RAJONEVE, Raportim për Politikën e zgjerimit të BE-së për vitin 2016 (KOM (2016) 715 versioni final), Bruksel, 9 nëntor 2016, SVD(2016) 362 versioni final, fq. 85 (https://www.sobranie.mk/content/%D0%9D%D0%A1%D0%95%D0%98/izveshtaj_na_evropskata_komisija_za_republika_makedonija_2016_godina-mk2-raboten_prevod.pdf)

e madhe edhe formalisht janë përfaqësuar në KNI, me qëllim të sigurimit të reagimit në kohë të duhur. Në këtë kontekst, konfirmim për përkushtimin e jashtëzakonshëm të Byrosë në realizimin e mandatit të saj në aspektin e ekzekutimit, është konstatimi i përfshirë në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2018, ku në kontekstin e reduktimit të numrit të aktgjyimeve të GJEDNJ-së, të cilat presin ekzekutimin e tyre, merita të veçanta i përshkruhen Byrosë, me ç’rast theksohet se “Byroja e Përfaqësimit para GJEDNJ-së ishte instrument për përmirësimin e ekzekutimit, edhe krahas faktit se në aspektin e kuadrove ishte pamjaftueshëm e ekipuar.”⁷³

Llogaridhënia në punën e Komisionit Ndërinstitucional sigurohet përmes raportit vjetor për punën e tij, si obligim ligjor i cili rezulton nga neni 13 i Ligjit për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ-së. Ky raport i dërgohet Qeverisë, Kuvendit dhe Komisionit të Përhershëm Anketues për Liritë dhe të Drejtat e Qytetarit. Në mënyrë plotësuese, sipas nenit 20 të Ligjit për Përfaqësim para GJEDNJ-së edhe Byroja harton raport vjetor për punën e vet, të cilin Ministri i Drejtësisë ia dërgon Qeverisë dhe Kuvendit, ndërkaq raporti përmban të dhëna për punën e Byrosë, pasqyrë të lëndëve rrjedhëse dhe të përfunduara para Gjykatës, pasqyrë të mjeteve të përcaktuara për aplikantët, analizë të strukturës dhe karakteristikave të aplikacioneve, analizë të aktgjyimeve sipas fushave dhe analizë të ekzekutimit të aktgjyimeve të Gjykatës.

Edhe pse me Ligjin për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe me Ligjin për Përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut nuk është parashikuar obligimi për prezantimin publik të raporteve vjetore të Byrosë, përkatësisht të Komisionit Ndërinstitucional para deputetëve, ndërsa një obligim i këtillë nuk rezulton as nga Rregullorja e Kuvendit, mund të vërehet se një praktikë e këtillë megjithatë është vendosur gjatë viteve të fundit. Kjo korrespondon me standardet e Këshillit të Evropës dhe me praktikën krahasuese të dhomave ligjvënëse në mbarë Evropën. Në këtë mënyrë, përforcohet dialogu midis Agjentit të Qeverisë si koordinator i llojit të vet të procesit të ekzekutimit dhe Kuvendit si bartës i pushtetit ligjvënës, ndërsa nga ana tjetër fuqizohet roli i tij mbikëqyrës mbi zbatimin e detyrimeve të ndërmarra ndërkombëtare të shtetit në lidhje me implementimin e Konventës në nivel kombëtar.⁷⁴

⁷³ Commission staff working document, The former Yugoslav Republic of Macedonia 2018 Report Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, 2018 Communication on EU Enlargement Policy, Strasbourg, 17.4.2018, SWD(2018) 154 final, fq. 27 (<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/20180417-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-report.pdf>)

⁷⁴ Për shembull, raportet vjetore për vitin 2018, janë shqyrtuar në mbledhjen e Komisionit të përhershëm anketues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarit, e cila është mbajtur më datën 6 qershor të vitit 2019. Shih: https://sobranie.mk/2016-2020-srm-ns_article-devetta-sednica-na-postojanata-anketna-komisija-za-zashtita-na-slobodite-i-pravata-na-gragjaninot.nspix. Diskutim i ngjashëm publik para këtij trupi punues të Kuvendit u mbajt më 2 qershor të vitit 2021, në kuadër të së cilit Agjenti i Qeverisë, zonja Danica Xhonova i prezantoi të dy raportet vjetore për punën e Byrosë së Përfaqësimit në GJEDNJ dhe për punën e Komisionit Ndërinstitucional për vitin 2020.

III.3. Pasqyra e gjendjeve lidhur me ekzekutimin e aktgjyimeve kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut

Nga dita e ratifikimit të KEDNJ-së më 10 prill të vitit 1997, u krijua e drejta për paraqitjen e ankesave individuale (aplikacioneve) kundër shtetit, në përputhje me nenin 34 të KEDNJ-së, përmes të cilave artikulohe pretendime ankimore për shkeljen e lirive dhe të drejtave të cilat i mbron Konventa.

Duke i proceduar aplikacionet individuale, të paraqitura në lëndët maqedonase, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut përfundimisht me muajin shtator të vitit 2021, miratoi gjithsej 184 aktgjyime kundër shtetit, prej të cilave pjesa më e madhe është miratuar në formacionin gjyqësor të Dhomës me shtatë gjyqtarë (150), një numër më i vogël nga Komiteti me 3 gjyqtarë (32), ndërsa vetëm 2 (dy) nga Dhoma e Madhe me shtatëmbëdhjetë gjyqtarë. Përveç kësaj, u miratuan edhe 501 vendime.⁷⁵

Sipas evidencës së Komitetit të Ministrave, që është përfshirë në bazën e të dhënave HUDOK EKSEK, nga momenti i regjistrimit të lëndës së parë maqedonase në KM e formuar sipas aktgjykimit *Janeva*⁷⁶ në vitin 2002, përfundimisht me fillimin e muajit nëntor të vitit 2021, në mbikëqyrje të ekzekutimit kanë qenë gjithsej 351 lëndë maqedonase. Këto janë kategorizuar nga KM-ja në këtë mënyrë: 61 lëndë kryesore dhe 112 të përsëritura, ndërsa 186 vendime për ujdë miqësore. Aktualisht, në rrjedhë e sipër është procedimi i 49 lëndëve, prej të cilave 40 aktgjyime dhe 9 vendime për ujdë miqësore, ndërsa të gjitha lëndët e tjera të cilat bëjnë pjesë në evidencën e lartpërmendur të përgjithshme të lëndëve tanimë janë të mbyllura.

Së këtejmi, nëse analizohet kohëzgjatja e ekzekutimit të aktgjyimeve maqedonase para Komitetit të Ministrave, parë nga prizmi i rasteve “kryesore” të cilat janë mbyllur me rezoluta përfundimtare, për shembull, ekzekutimi i 5 (pesë) lëndëve është mbyllur në vitin 2019, ka zgjatur më shumë se 5 (pesë) vjet, për 4 (katër) lëndë ekzekutimi ka zgjatur 2 (dy) deri 5 (pesë) vjet, dhe në po aq lëndë, ekzekutimi ka zgjatur më pak se 2 (dy) vjet.⁷⁷ Të dhëna të ngjashme janë të qasshme edhe për të gjitha vitet paraprake.⁷⁸

Sipas të dhënave të prezantuara statistikore nga ana e Komitetit të Ministrave, në dhjetë vitet e fundit, vetëm në bazë të shumave të dëshmperblimit të drejtë të cilat janë përcaktuar

⁷⁵ Sa u përket aplikacioneve të paraqitura në GJEDNJ, vetëm në vitin 2020, është vepruar ndaj gjithsej 300 lëndëve kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut, prej të cilave 277 kanë përfunduar me vendim për palejueshmëri ose për shlyerjen nga lista e lëndëve, ndërsa sa u përket 23 aplikacioneve të tjera, janë miratuar gjithsej 14 aktgjyime. Edhe në vitet paraprake, gjendja ka qenë e ngjashme, ndërsa GJEDNJ-ja ka vendosur për një numër përafërsisht të njëjtë të aplikacioneve (278 në vitin 2018 dhe 257 në vitin 2019). Për më shumë detaje, shih: https://www.echr.coe.int/Documents/CP_Republic_of_North_Macedonia_ENG.pdf

⁷⁶ *Janeva*, nr. 58185/00, aktgjykim nga data 3 tetor e vitit 2002

⁷⁷ Raporti vjetor për punën e Komisionit Ndërinstitucional për vitin 2019, fq.11 i qasshëm këtu: <http://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2020/05/2019-%D0%93%D0%9E%D0%94%D0%98%D0%A8%D0%95%D0%9D-%D0%98%D0%97%D0%92%D0%95%D0%A8%D0%A2%D0%90%D0%88-%D0%9C%D0%9A-13.05.pdf>

⁷⁸ Për më shumë informacione shih raportet e tjera vjetore për punën e Komisionit Ndërinstitucional, të cilët janë të qasshëm në ueb-faqen e Byrosë së Përfaqësimit para GJEDNJ-së, këtu: <https://biroescp.gov.mk/%d0%b3% d0%be% d0%b4% d0%b8% d1%88% d0%bd% d0%b8-% d0%b8% d0%b7% d0%b2% d0%b5% d1%88% d1%82% d0%b0% d0%b8/>

me aktgjykimet dhe vendimet e GJEDNJ-së janë paguar gjithsej 2.207.925 euro, e që mesatarisht është rreth 220.000 euro në nivel vjetor. Vërehet se në çdo vit të radhës ka një tendencë të rritjes së vazhdueshme të këtyre shumave.⁷⁹

2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
165.084	337.150	353.408	301.240	139.145	102.870	87.530	124.900	266.915	329.683

III.4. Ndryshimet sistematike në lidhje me ekzekutimin e aktgjyimeve të GJEDNJ-së kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Arritjet kryesore të ekzekutimit të aktgjyimeve maqedonase kur bëhet fjalë për ndërhyrjet e përgjithshme në legjislacion, miratimin e politikave të reja ose vendosjen e praktikës së re gjyqësore dhe/ose administrative, mund të prezantohen përmes përvojës së deritanishme me mbylljen e suksesshme të disa lëndëve ose grupeve të lëndëve më të rëndësishme para Komitetit të Ministrave.

Shembulli i parë i ilustrimit ka të bëjë me **zvarritjen e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore vendase dhe me mosekzistimin e mjetit efikas juridik** për adresimin e shkeljes së këtyllë të Konventës. Inkorporimi i kërkesës për mbrojtjen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm para Gjykatës Supreme në Ligjin për Gjykatat, si mjet juridik efikas me të cilin zgjidhet problemi i zvarritjes së kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore, bashkë me një sërë ndërhyrjesh tjera të legjislacionit në ligje të ndryshme të procesit (Ligji për Procedurën Kontestimore, Ligji për Procedurën Penale dhe Ligji për Kontestet Administrative) rezultuan me mbylljen e 56 lëndëve në të cilat u konstatua shkelja e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm sipas nenit 6, të cilat i përkasin grupit të lëndëve *Atanasoviq dhe të tjerët*.⁸⁰

Me miratimin e Ligjit të ri për Konteste Administrative më 25 shkurt të vitit 2019,⁸¹ në nenin 9 si njëri nga parimet kryesore u përcaktua **parimi i seancës verbale**, që nënkupton detyrim eksplicit për Gjykatën Administrative, vendimin **në kontestin administrativ** ta miratojë në bazë të seancës publike, të drejtpërdrejtë dhe verbale, me ç'rast ajo mund të vendos në kontestin administrativ pa mbajtur seancë vetëm në rastet e përcaktuara me ligj. Me këtë zgjidhje ligjore duhet të parandalohen shkeljet e të drejtës së gjykimit të drejtë sipas nenit 6

⁷⁹ Megjithatë duhet pasur parasysh se, megjithëse këto shuma duken mjaft të larta, veçanërisht pasi pagesa e tyre bëhet nga mjetet e buxhetit shtetëror, deri më tani nuk është bërë ndonjë hulumtim i detajuar për atë se sa pagesa bëhen nga buxheti shtetëror për dëshmperblime të ndryshme (si për shembull, kompensim të dëmit për shkak të gjyimeve të pabazuara ose privimeve të pabazuara nga liria), të cilat në një masë të caktuar kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Kjo analizë do të ndihmojë që të ketë një pasqyrë të plotë të shpenzimeve të përgjithshme të cilat rezultojnë nga mosrespektimi i të drejtave të njeriut, të cilat në fund të fundit, bien në kurriz të qytetarëve.

⁸⁰ Resolution CM/ResDH(2016)35, Execution of the judgments of the European Court of Human Rights Atanasovic and others and 55 cases against “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Adopted by the Committee of Ministers on 8 March 2016 at the 1250th meeting of the Ministers’ Deputies), Final Resolution CM/ResDH(2016)35

⁸¹ Ligji për Kontestet Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 96/2019 nga data 17.5.2019)

të KEDNJ-së, të ngjashme me ato që u konstatuan në lëndën *Mitkova*.⁸² Për këtë shkak, këto masa ligjore, në masë të madhe, kontribuuan në mbylljen e suksesshme të ekzekutimit të kësaj lënde me rezolutë përfundimtare të KM-së.⁸³

Për më tepër, Ligji i ri për Konteste Administrative në mënyrë konsekuente e inkorporoi **parimin e kontradiktës**, në përputhje me të cilin Gjykata do t'u mundësojë palëve të deklarohe në lidhje me pretendimet dhe propozimet e palës së kundërt.⁸⁴ Në këtë kuptim, inkorporohet detyrimi ligjor për gjykatat administrative që ankuesit t'ia dërgojnë përgjigjen e ankesës të paraqitur nga pala tjetër (neni 76 paragrafi 2). Këto ndryshime ligjore ishin kryesore për mbylljen e lëndëve *Naumoski*⁸⁵ dhe *Taseva Petrovska*.⁸⁶

Në kontekst të lëndës *Petkoski dhe të tjerët*, Komiteti i Ministrave konsideron se kufizimi i të drejtës së aplikantëve për **qasje në gjykatë** nga neni 6 i Konventës për shkak të jokompetencës gjyqësore, me ç'rast gjykatat nuk e kanë specifikuar autoritetin/organin i cili do të jetë kompetent për procedimin meritor të asaj lënde, në mënyrë përkatëse u zgjidh me zgjidhjen e re ligjore të inkorporuar në ndryshimet e Ligjit për Gjykatat nga viti 2008.⁸⁷ Me fjalë të tjera, sipas nenit 8 të këtij Ligji, “gjykata thirret në jokompetencë gjyqësore vetëm atëherë kur me ligj në mënyrë eksplicite është parashikuar kompetenca për zgjidhjen e kërkesës konkrete të autoritetit tjetër shtetëror” dhe ai “nuk mund ta hedhë poshtë kërkesën për realizimin e një të drejte të caktuar me justifikimin se ekziston vakum juridik dhe se e ka për detyrë të vendos sipas tij, duke iu referuar parimeve të përgjithshme të së drejtës, përveç në rastin kur një gjë e këllillë ndalohe në mënyrë eksplicite me ligj.”⁸⁸

Themelimi i departamentit të veçantë për praktikë gjyqësore i cili do të kujdeset për unifikimin dhe harmonizimin e praktikës së gjykatave vendase, është një hap i rëndësishëm drejt mbylljes së lëndës *Atanasovski*, ku burimi i shkeljes së **parimit të sigurisë juridike** të nenit 6 nga KEDNJ-ja, është përcaktuar në praktikën gjyqësore divergjente, kreatore e së cilës ka qenë pikërisht Gjykata Supreme. Për më shumë, në lidhje me lëndën *Stoilkovska*, e cila bën pjesë në grupin e njëjtë të lëndëve me *Atanasovski*, ku shkelja është bërë për shkak të praktikës jokonsekuente në nivelin e gjykatave të shkallës së dytë, si masë e përgjithshme për parandalimin e gjendjeve të ngjashme në të ardhmen, është vendosur të mbahen

⁸² *Mitkova*, nr. 48386/09, aktgjykim nga 15 tetori 2015

⁸³ Resolution CM/ResDH(2019)195, Execution of the judgment of the European Court of Human Rights *Mitkova* against North Macedonia (Adopted by the Committee of Ministers on 4 September 2019 at the 1352nd meeting of the Ministers' Deputies)

⁸⁴ Neni 10 paragrafi 1 i Ligjit të ri për Kontestet Administrative

⁸⁵ Resolution CM/ResDH(2018)56, Execution of the judgment of the European Court of Human Rights *Naumoski* against “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Adopted by the Committee of Ministers on 14 February 2018 at the 1307th meeting of the Ministers' Deputies)

⁸⁶ Resolution CM/ResDH(2019)197, Execution of the judgment of the European Court of Human Rights *Taseva Petrovska* against North Macedonia (Adopted by the Committee of Ministers on 4 September 2019 at the 1352nd meeting of the Ministers' Deputies)

⁸⁷ Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykata (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 35 nga data 14.3.2008)

⁸⁸ Kjo lëndë është mbyllur me Resolution CM/ResDH(2018)55, Execution of the judgment of the European Court of Human Rights *Petkoski and Others* against “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Adopted by the Committee of Ministers on 14 February 2018 at the 1307th meeting of the Ministers' Deputies)

mbledhje të rregullta dhe të miratohen konkluzione në nivel të departamenteve civile të katër gjykatave të apelit.⁸⁹

Një reagim i ngjashëm nga ana e gjykatave është nënvizuar edhe në lidhje me lëndën *Selami*, ku GJEDNJ-ja ka konstatuar se aplikanti u është ekspozuar veprimeve të torturës në kundërshtim me nenin 3, ndërkaq gjykatat vendase gjatë përcaktimit të kompensimit për privimin e pabazë nga liria dhe mbajtjen në lokacion të panjohur nga ana e policisë nuk kanë pranuar (në mënyrë eksplicite ose faktike) se trajtimi i këllillë nënkupton torturë, që ka rezultuar me shkeljen e nenit 3 (ndalimi i torturës) dhe të nenit 5 paragrafi 5 (e drejta e kompensimit në rast të privimit të paligjshëm nga liria) nga KEDNJ-ja. Në kontekstin e ekzekutimit të këtij aktgjykimi, rëndësi jashtëzakonisht të madhe ka konkluzioni i miratuar nga katër gjykatat e apelit, në dhjetor të vitit 2018, i cili është i detyrueshëm për gjykatat e shkallës së parë. Ai është formuluar në kuptimin se lartësia e **kompensimit monetar të cilën gjykatat ua caktojnë personave të privuar në mënyrë të paligjshme nga liria, që i janë nënshtruar torturës, trajtimit apo dënimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës** në bazë të shkeljes së të drejtave personale – dëmi jomaterial, duhet të caktohet në shumën e cila korrespondon me praktikën e vendosur të GJEDNJ-së, duke u udhëhequr nga çështja *Selami* dhe nga çështje tjera të ngjashme. Ky konkluzion mund të trajtohet si masë e rëndësishme e përgjithshme për harmonizimin e praktikës gjyqësore vendase me standardet e Strasburgut dhe parandalimin e shkeljeve të ngjashme, kështu që, është e kuptueshme se pas miratimit të tij lënda u mbyll me Rezolutë përfundimtare të KM-së.⁹⁰

Ndërmarrja e masave të përgjithshme të karakterit legjislativ ka rëndësi vendimtare për mbylljen e tri lëndëve: *Ivanovski, Karajanov dhe Bileski*, në të cilat është konstatuar shkelja e të drejtës së procedurës së drejtë gjyqësore të nenit 6 nga Konventa e cila ka të bëjë me mangësitë e **procedurës së lustrimit**, veçanërisht edhe nga aspekti i justifikimit të vendimeve gjyqësore, ndërsa tek një pjesë e tyre edhe sa i përket të drejtës së respektimit të jetës private dhe familjare të nenit 8 (*Ivanovski dhe Karajanov*). Këto masa, fillimisht kishin të bëjnë me miratimin e Ligjit për Ndërprerjen e Vlefshmërisë së Ligjit për Lustrim.⁹¹ Në përputhje me këtë Ligj, Komisioni për Verifikimin e Fakteve (i njohur si Komisioni për Lustrim) nga 1 shtatori i vitit 2015, nuk ka pasur mandat për hapjen e procedurave të reja të lustrimit konform Ligjit të vjetër, dhe janë ndërprerë të gjitha procedurat e filluara për të cilat deri më 1 shtator të vitit 2015 nuk janë miratuar aktvendime nga ana e Komisionit, ndërkaq nga ana tjetër, është përcaktuar se Komisionit i ka pushuar mandati me kryerjen përfundimtare të procedurave tanimë të filluara, dhe më së voni në afat prej 2 (dy) vitesh nga dita e fillimit të zbatimit

⁸⁹ Dy lëndët janë mbyllur me rezolutën përfundimtare të KM Resolution CM/ResDH(2015)152, Execution of the judgments of the European Court of Human Rights in Two cases against “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Adopted by the Committee of Ministers on 24 September 2015 at the 1236th meeting of the Ministers' Deputies)

⁹⁰ Resolution CM/ResDH(2019)65, Execution of the judgment of the European Court of Human Rights *Selami* and Others against North Macedonia (Adopted by the Committee of Ministers on 27 March 2019 at the 1342nd meeting of the Ministers' Deputies)

⁹¹ Ligji për Ndërprerjen e Vlefshmërisë së Ligjit për Përcaktimin e Kushtit për Kufizimin e Ushtrimit të Funkcionit Publik, Qasjes në Dokumente dhe Publikimit të Bashkëpunimit me Organet e Sigurisë Shtetërore (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 143/2015 nga data 24.8.2015)

të këtij Ligji.⁹² Këto ndërhyrje në legjislacion kanë rezultuar me mbylljen e suksesshme të implementimit të lëndëve të lustrimit para KM-së.⁹³

Nga aspekti i nenit 10 (liria e shprehjes), duhet të shënohet **dekriminalizimi i fyerjes dhe shpifjes** përmes miratimit të Ligjit për Përgjegjësi Qytetare për Fyerje dhe Shpifje në vitin 2012.⁹⁴ Me nenin 2 të këtij Ligji u parashikua se “kufizimet e lirisë së shprehjes dhe informimit rregullohen me ligj përmes përcaktimit të kushteve të rrepta për përgjegjësi qytetare për fyerje dhe shpifje, në përputhje me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (neni 10) dhe praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.”

Njëkohësisht, me nenin 3 në mënyrë të drejtpërdrejtë u jepet përparësi dispozitave të Konventës dhe pikëpamjeve të GJEDNJ-së të përfshira në aktgjykimet e saj, në rast të ekzistimit të vakumit ligjor ose në rast të konfliktit të dispozitave të këtij Ligji me Konventën. Përmes këtyre ndërhyrjeve ligjore u mbyll mbikëqyrja e ekzekutimit të lëndës *Makraduli*,⁹⁵ ku shkelja e nenit 10 kishte të bëjë me përgjegjësinë e përcaktuar penale dhe me sanksionin e shqiptuar penal për nënkryetarin e partisë së atëhershme në opozitë në lidhje me deklaratimet e tij të dhëna në një pres-konferencë partiake, e që e vë në dukje abuzimin e autorizimeve të drejtorit të atëhershëm të Drejtorisë së Sigurisë dhe Kundërzbulimit, përndryshe kushëri i kryeministrit të atëhershëm.

Kjo masë e përgjithshme ligjore, gjithsesi se do të jetë relevante edhe në kontekstin e adresimit të shkeljes së lirisë së shprehjes në lëndën *Gelevski*,⁹⁶ ku aplikanti, i cili ishte opinionist në një gazetë ditore, u dënua penalisht për kritikën që ia ka adresuar një gazetari. Përndryshe, mbikëqyrja e ekzekutimit të kësaj lënde akoma është në rrjedhë e sipër para KM-së, ndërkaq pritet që shteti ta paraqesë planin e veprimit të saj të parë iniciues në afatin gjashtëmuor pas aktgjykimit përfundimtar.

Edhe një reformë në kuadrin ligjor e cila u implementua me miratimin e Ligjit të ri për Shoqatat dhe Fondacionet në vitin 2010⁹⁷, me të cilën u lehtësuan **procedurat e regjistrimit**,

⁹² 1302 meeting (December 2017) (DH), Action report (12/10/2017), Communication from “the former Yugoslav Republic of Macedonia” concerning the case of IVANOVSKI v. “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Application No. 29908/11), DH-DD(2017)1162, paragrafët 20 – 24

⁹³ Shih, për shembull, Resolution CM/ResDH(2017)428, Execution of the judgment of the European Court of Human Rights Ivanovski against “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Adopted by the Committee of Ministers on 7 December 2017 at the 1302nd meeting of the Ministers’ Deputies); Resolution CM/ResDH(2018)311, Execution of the judgment of the European Court of Human Rights Karajanov against “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Adopted by the Committee of Ministers on 5 September 2018 at the 1322nd meeting of the Ministers’ Deputies) dhe Resolution CM/ResDH(2020)74, Execution of the judgment of the European Court of Human Rights Bileski against North Macedonia (Adopted by the Committee of Ministers on 4 June 2020 at the 1377th meeting of the Ministers’ Deputies).

⁹⁴ (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 143 nga data 14.11.2012)

⁹⁵ Resolution CM/ResDH(2019)190, Execution of the judgment of the European Court of Human Rights Makraduli against North Macedonia (Adopted by the Committee of Ministers on 4 September 2019 at the 1352nd meeting of the Ministers’ Deputies)

⁹⁶ *Gelevski*, nr. 28032/12, aktgjykim nga 8 tetori 2020

⁹⁷ Ligji për Shoqatat dhe Fondacionet (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 52 nga 16 prilli 2010)

nga ana e KM-së, u perceptua si një masë e përgjithshme dhe e rëndësishme esenciale me të cilën u mbyll lënda *Shoqata e qytetarëve “Radko” dhe “Paunkovski”*.⁹⁸ Si rezultat i kësaj reforme, Regjistri Qendror si autoriteti kompetent për regjistrim është i autorizuar ta shqyrtojë vetëm atë se a janë përmbushur kërkesat e procesit për regjistrimin e ndonjë shoqate të caktuar të qytetarëve, duke mos bërë shqyrtime meritore të ligjshmërisë së akteve të saj të themelimit, që ka qenë ndryshe kur këtë kompetencë e kishin gjykatat, si në kohën kur u bë shkelja e lirisë së asociimit nga neni 11, që u konstatua në lëndën “Radko”.

Shfuqizimi i **heqjes me automatizëm të mjeteve** kur është kryer vepër e caktuar penale, siç është kontrabandimi i mallit, përkatësisht i mjeteve transportuese të përdorura për kontrabandimin e emigrantëve, me ndërhyrje në Kodin Penal (KP) ishte bazë për mbylljen e mbikëqyrjes së ekzekutimit të lëndëve *Vasilevski*⁹⁹ dhe *Andonovski*.¹⁰⁰

⁹⁸ Resolution CM/ResDH(2017)293, Execution of the judgment of the European Court of Human Rights Association of Citizens “Radko” and Paunkovski against “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Adopted by the Committee of Ministers on 21 September 2017 at the 1294th meeting of the Ministers’ Deputies)

⁹⁹ Resolution CM/ResDH(2017)145, Execution of the judgment of the European Court of Human Rights Vasilevski against “the former Yugoslav Republic of Macedonia” (Adopted by the Committee of Ministers on 10 May 2017 at the 1286th meeting of the Ministers’ Deputies)

¹⁰⁰ Resolution CM/ResDH(2019)301, Execution of the judgment of the European Court of Human Rights Andonoski against North Macedonia (Adopted by the Committee of Ministers on 13 November 2019 at the 1360th meeting of the Ministers’ Deputies)

PIKËPAMJET PËRFUNDIMTARE

Ekzekutimi i aktgjytimeve të GJEDNJ-së, gjithsesi se paraqet një proces kompleks të cilit i nevojitet përfshirje aktive dhe bashkëveprim konstruktiv i disa faktorëve, të cilët përmes **bashkëpunimit dhe ndërveprimit të koordinuar të ndërsjellë** duhet t'i identifikojnë masat dhe aktivitetet më të drejta dhe më përkatëse të cilat duhet të ndërmerren, dinamikën kohore të implementimit të tyre, ta monitorojnë me rregullsi rrjedhën e implementimit të të njëjtave dhe të reagojnë në kohë të duhur në rast të vështirësive eventuale apo në rast të shfaqjes së sfidave të reja të (pa)pritshme në procesin e përgjithshëm.

Rruga deri në implementimin përfundimtar dhe të suksesshëm të një aktgjykimi shpeshherë është rrugë e gjatë dhe e vështirë meqë e njëjta kalon përmes Byrosë së Përfaqësimit të Shtetit para GJEDNJ-së si autoriteti shtetëror i cili pranon notifikim zyrtar nga Regjistri i Gjykatës në lidhje me aktgjykimin përfundimtar dhe pastaj rruga vazhdon përmes Komisionit Ndërinstitucional për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ-së, gjykatave, prokurorive publike, ministrive, organeve të administratës shtetërore, Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë.

Siç është prezantuar në këtë publikim, ligjet për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe për përfaqësimin e shtetit para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e përbëjnë kuadrin ligjor brenda të cilit zhvillohet procesi i përgjithshëm i ekzekutimit të aktgjytimeve të Gjykatës së Strasburgut në nivel kombëtar. Me fjalë të tjera, këto ligje bëjnë përpjekje për përafrimin e problematikës që ka të bëjë me ekzekutimin e aktgjytimeve të GJEDNJ-së dhe me mbikëqyrjen të cilën e implementon Komiteti i Ministrave, si dhe krijimin e strukturës e cila në nivel kombëtar duhet të kujdeset për ekzekutimin e aktgjytimeve të GJEDNJ-së.

Megjithatë, duhet të merret parasysh se shteti në këtë përpjekje është relativisht unik në mesin e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës duke e pasur në konsideratë numrin e vogël të shteteve të cilat ia kanë mësy rregullimit ligjor të kësaj materie që ka të bëjë me ekzekutimin e aktgjytimeve të GJEDNJ-së.

Për më tepër, është e pakontestueshme se zgjidhjet ligjore u miratuan në rendin juridik vendas para inkorporimit të reformave në procesin e ekzekutimit të aktgjytimeve të GJEDNJ-së nga viti 2011. E gjithë kjo, marrë në përgjithësi, e imponon nevojën **seriozisht të mendohet për rishikimin dhe revidimin e legjislacionit në fuqi në drejtim të modernizimit dhe harmonizimit të tij me reformat e sistemit të mbikëqyrjes së ekzekutimit** të cilat në ndërkohë, u krijuan në nivel të Këshillit të Evropës.

Në këtë drejtim është edhe fakti se krahas strukturës solide institucionale të sistemit kombëtar për ekzekutimin e aktvendimeve të GJEDNJ-së, me një rol të theksuar të Komisionit Ndërinstitucional dhe Agjentit të Qeverisë – Drejtorit të Byrosë së Përfaqësimit si koordinator dhe bartës i ekzekutimit dhe me pjesëmarrje të caktuar të subjekteve tjera relevante, megjithatë në një numër të madh të rasteve ekzekutimi i lëndëve të caktuara

stagnon, dhe së këtejmi pastaj kërkohet të ndërmerret një angazhim më intensiv brenda një periudhë më të shkurtër kohore për t'iu përgjigjur emergjencës së kërkesave dhe pritshmërive të Komitetit të Ministrave. Duke iu referuar kësaj, do të ishte mirë në një të ardhme të afërt **të bëhet një vlerësim dhe rishikim i detajuar i rolit dhe kapaciteteve të secilës prej palëve të interesuara në mënyrë që të sigurohet përfshirja dhe aktiviteti i tyre më i madh** dhe të garantohet sukses më i madh në këtë proces.

Nga ana tjetër, edhe karakteri subsidiar i sistemit të Konventës determinon sjellje të kujdeshme të çdo personi i cili gjatë ushtrimit të autorizimeve të veta zyrtare mund ta shkelë Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duke e pasur parasysh detyrimin primar të shtetit për implementimin përkatës të Konventës, meqë problemet dhe shkeljet më së lehti dhe pa shumë vështirësi parandalohen dhe shmangen brenda vendit, pa pasur fare nevojë që pretendimet e shkeljeve të prezantohen para ndonjë forumi ndërkombëtar, siç është Gjykata e Strasburgut.

Pikërisht për këtë, të gjitha institucionet dhe të gjithë individët duhet ta ndërmarrin rolin e “agjentëve” të llojit të vet për ekzekutimet dhe ndryshimet që duhet të ndodhin dhe së këtejmi ta japin kontributin e tyre maksimal në implementimin e suksesshëm të aktgjytimeve të GJEDNJ-së në kontekstin maqedonas. Do të kishte rëndësi jashtëzakonisht të madhe nëse ata manifestojnë një qasje proaktive në këtë proces, duke ndërmarrë iniciativa personale për ndryshime konkrete në kuadër të institucioneve të caktuara apo në nivel të nënsistemeve integrale të cilat janë prekur me shkeljet e konstatuara të Konventës përmes aktgjykitimit të Gjykatës, ndërsa nuk duhet të presin që hapin e parë drejt ekzekutimit të aktgjytimeve ta ndërmerr Byroja e Përfaqësimit, përkatësisht Komisioni Ndërinstitucional.

Vetëm përmes qasjes aktive, në mënyrë të pashmangshme do të reduktohet numri i aplikacioneve potenciale në Gjykatë, si dhe numri i aktgjytimeve të cilat shtetit i imponojnë detyrime për ekzekutimin e tyre e që ka nevojë për shfrytëzimin e resurseve kadrovike të institucioneve të cilat duhet të përfshihen në procesin e ekzekutimit, dhe për mjete financiare nga buxheti për pagesën eventuale të kompensimit të caktuar të drejtë, i cili në këtë mënyrë në masë të konsiderueshme do të ishte më i ulët.

Në afat të gjatë, implementimi efikas i aktgjytimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut duhet të kontribuojë në ndërtimin dhe zhvillimin e kulturës së respektimit konsekuent të detyrimeve të ndërmarra ndërkombëtare nga ana e shtetit, që duhet ta parandalojë cenimin e mëttutjeshëm të reputacionit ndërkombëtar të tij përmes shqiptimeve të shpeshta të aktgjytimeve negative të reja në të cilat ai mund t'i ekspozohet gjykitimit publik për shkeljen e bërë ndaj të drejtave themelore të njeriut të cilat i garanton Konventa.

Përfundimisht, në këtë mënyrë do të gjenerohet një ndikim (impakt) më largpamës mbi gjendjet e përgjithshme që kanë të bëjnë me sundimin e së drejtës dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut brenda shtetit, që në mënyrë pozitive mund të pasqyrohet jo vetëm mbi përmbushjen e detyrimeve për ekzekutimin e aktgjytimeve të GJEDNJ-së, të cilat burojnë nga anëtarësia e shtetit në Këshillin e Evropës, por edhe mbi përmbushjen e disa prej supozimeve kryesore të anëtarësimit të ardhshëm të shtetit në Bashkimin Evropian.

